

Koalicioni i OJQ-ve "Të gjithë për gjykim të drejtë"

Misioni i OSBE-së në Shkup

Prof.dr Boban Misoski, Fakultetit Juridik "Justinianus Primus", Shkup

Darko Avramovski

Natali Petrovska, avokate

**ANALIZË**  
E TË DHËNAVE NGA  
VËZHGIMI I PROCEDURAVE GJYQËSORE  
NË FUSHËN E KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE  
KORRUPSIONIT NË VITIN 2019

**Autorët:**

Prof.dr Boban Misoski, Fakultetit Juridik “Justinianus Primus”, Shkup

Darko Avramovski

Natali Petrovska, avokate



Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimin apo qëndrimin e Misionit të OSBE-së në Shkup.

Shkup, dhjetor 2019

# PËRMBAJTJA

Hyrje .....	50
Korniza ligjore .....	50
Metodologjia .....	52
Të dhëna të përgjithshme .....	53
Kushtet për mbajtjen e seancës .....	55
E drejta për avokat mbrojtës .....	58
Masat për sigurimin e pranisë së të akuzuarit .....	59
Këshillat për të drejtat .....	66
Zbatimi i pranimit të fajit .....	68
Shqyrtimi kryesor - procedura e provave .....	75
E drejta për gjykim të drejtë .....	81
Barazia e armëve .....	81
E drejta për gjykim publik .....	83
Prezumimi i pafajësisë .....	85
E drejta e mbrojtjes .....	86
Aktgjykimi .....	87
Përfundime dhe rekomandime .....	90

## HYRJE

Koalicioni “Të gjithë për gjykim të drejtë” është rrjet i 13 organizatave të shoqërisë civile, i formuar si organizatë me misionin kryesor për t’i vëzhguar proceset gjyqësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me qëllim të rritjes së respektimit të standardeve për gjykime të drejta para gjykatave të vendit, identifikimit të problemeve të trashëguara në sistemin gjyqësor dhe nxjerrjes në pah të nevojës për reforma ligjore dhe institucionale, njoftimit të publikut me standardet për gjykim të drejtë, zvogëlimit të mundësisë për trajtim joadekuat të palëve në kontest nga ana e gjyqtarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurë dhe forcimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe gjyqësinë në përgjithësi.

Nevoja në rritje për procese reformuese në vitet e fundit, e veçanërisht iniciimi i procesit të reformave në gjyqësi që ndikon drejtpërdrejt ose indirekt në punën e gjykatave, ishte një motiv shtesë për Koalicionin për të vazhduar me monitorimin sistematik të procedurave gjyqësore. Sikurse edhe vitet e kaluara, ashtu edhe këtë vit, Koalicioni këto aktivitete i realizoi në cilësinë e partnerit implementues dhe me mbështetje financiare nga Misioni i OSBE-së në Shkup, mirëpo këtë vit, ndryshe nga 4 vitet e kaluara, përqendrimi ishte në një fushë tematike veçanërisht specifike të krimit, konkretisht në krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Kjo fushë nuk është risi në fushëveprimin tematik të organizatës. Në fakt, ajo ka zhvilluar një program për vëzhgimin e lëndëve penale gjyqësore të lidhura me korrupsionin që në vitin e largët 2007, përmes një projekti pilot në kuadër të të cilit u mblodhën materiale empirike në bazë të të cilave, më vonë, është analizuar dhe hulumtuar më tej kjo dukuri bashkëkohore, e cila vazhdoi të ndiqet deri në vitin 2017. Kësaj radhe, megjithatë, edhe vetë konteksti shoqëror e imponoi nevojën për kontroll të shtuar mbi institucionet që veprojnë, kur bëhet fjalë për krimin e organizuar dhe korrupsionin.

## KORNIZA LIGJORE

Korniza ligjore e nacionale, në të cilën për herë të parë parashihet Ligji për Parandalimin e Korrupsionit (vitit 2002), përmban një numër të madh dispozitash për promovimin e luftës kundër korrupsionit dhe parandalimin e tij, edhe atë, si në administratën publike, ashtu edhe në mesin e funksionarëve të zgjedhur/emëruar. Përmirësimi i efektivitetit të dispozitave të këtij ligji u bë më vonë me krijimin e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, i cili është paraparë të ketë rolin e një organi të pavarur përgjegjës për zbatimin e masave për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave. Dy vjet më vonë, në vitin 2004, u miratua Ligji i ri për Prokurorinë Themelore Publike, i cili parashikon krijimin e një Njësie të specializuar për veprat penale nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit, e cila në vitin 2007 kaloi në Prokurori të veçantë Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (PPNKOK), e cila merret me rastet që lidhen me krimin e organizuar dhe korrupsionin në nivelin e tërë territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 31 i Ligjit për Prokurorinë Themelore Publike (Gazeta Zyrtare e RM nr. 150, e datës 12.12.2007) i përcakton kompetencat e veprimit të kësaj prokurorie publike, por dhe theksohet di-apazoni i i asaj që do të trajtohet si korrupsion, gjegjësisht cilat vepra nga Kodi Penal i RMV-së janë të përfshira. Ky nen parasheh se “Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit është kompetente të veprojë për:

- vepra penale, të kryera nga një grup i strukturuar prej tre ose më tepër personash, i cili ekziston një periudhë të caktuar kohore dhe vepron me qëllim që të kryejë një apo më shumë vepra penale, për të cilat është paraparë dënim me burg me së paku katër vjet, me qëllim që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të përfitojë të mira financiare ose të mira të tjera,
- vepra penale, të kryera nga një grup i strukturuar apo nga organizatë kriminale në rajonin e Republikës së Maqedonisë së Veriut ose të shteteve të tjera apo kur vepra penale është përgatitur ose planifikuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut apo në shtet tjetër,
- vepra penale, keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizimit, nga neni 353, paragrafi (5), mit-marrje me vlerë të konsiderueshme nga neni 357 dhe ndërmjetësim kundërligjor nga neni 359, që të gjitha nga Kodi Penal, të kryera nga funksionari i zgjedhur ose i emëruar, nga personi zyrtar ose nga personi përgjegjës në personin juridik dhe
- vepra penale, prodhimi i paautorizuar dhe lëshimi në qarkullim i drogave narkotike, substan-cave psikotrope dhe prekursorëve, nga neni 215, paragrafi 2, larje parash dhe të hyra të tjera nga vepra penale, me vlerë më të madhe nga neni 273, rrezikim terrorist i rregullimit kushtetues dhe i sigurisë nga neni 313, mitëdhënie me vlerë të konsiderueshme nga neni 358, ndikim i jashtëligjshëm mbi dëshmitarët, nga neni 368-a paragrafi (3), shoqërim me qëllime kriminale, nga neni 394, organizatë terroriste, nga neni 394-a, terrorizëm nga neni 394-b, vepra penale tregti me njerëz, nga neni 418-a, vepra penale kontrabandë me emigrantë, nga neni 418-b, tregti me persona të mitur, nga neni 418-g, dhe për vepra të tjera penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare nga Kodi Penal, pavarësisht nga numri i kryerësve.<sup>1</sup>

Dispozitat e përcaktuara në këtë nen i pasqyrojnë format e larmishme në të cilat mund të paraqitet korrupsioni, gjë që tregon se ai është direkt ose indirekt i pranishëm në pjesën më të madhe të jetës sonë të përditshme. Numri i konventave të nënshkruara dhe të ratifikuara si dhe ndryshimet e shumta ligjore tregojnë se ka vullnet të sinqertë dhe se bëhen përpjekje nga ana e shtetit për ta luftuar korrupsionin dhe për t'u përballë me krimin e organizuar. Mirëpo, ato vetvetiu nuk garantojnë se ajo që është paraparë në to edhe do të zbatohet plotësisht. Pikërisht mungesa e kapacitetit dhe e vullnetit në kuadër të njësisë së veçantë brenda Prokurorisë Publike - Prokurorisë Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, për të vepruar dhe luftuar kundër këtij fenomeni modern, e imponoi nevojën për krijimin e një organi të posaçëm, *ad hoc*, të specializuar për këtë fushë, por për kryerës që, para së gjithash, janë figura politike dhe struktura të afërta me ta.

Në vitin 2015, në bazë të një ligji të posaçëm u themelua Prokuroria Publike për ndjekjen e veprave penale të cilat kanë të bëjnë dhe rezultojnë nga përmbajtja e ndjekjes së paligjshme të komunikimeve (PSP), qëllimi kryesor i të cilës ishte ndjekja penale e krimit të lartë (dhe të organizuar). Por, edhe pas pothuajse 4 vitesh nga krijimi i kësaj prokurorie të specializuar, e në rastin e PPNKOK-së kanë kaluar 15 vjet, gjegjësisht 12 vjet, sipas vlerësimit të fundit dhe indeksit të “Transparency International” për vitin 2018, Republika e Maqedonisë së Veriut është në vendin e 93-të nga 180 vende, e vlerësuar me 35 pikë në shkallën deri në 100 pikë për shkallën e korrupsionit të regjistruar<sup>2</sup> (ku numri më i vogël i pikëve është tregues për shkallë më të lartë të korrupsionit).

1 Ligji për Prokurorinë Themelore Publike (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 150, e datës 12.12.2007)

2 <https://www.transparency.org/cpi2018>

## METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur nga Koalicioni për t'i mbledhur të dhënat nga gjykimet që iu nënshtruan monitorimit për qëllimet e kësaj analize, konsistonte nga një hulumtim i përcaktuar në mënyrë specifike "në terren", duke i përdorur dy metoda: 1) monitorimi i procedurave gjyqësore gjatë mbajtjes së tyre nga ana e vëzhguesve të specializuar që nuk ishin pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në seanca dhe 2) një pyetësor i sistematizuar në të cilin, pas monitorimit të kryer, vëzhguesit i fushin të dhënat e vëzhguara.

Vëzhguesit e Koalicionit ishin të pranishëm fizikisht në sallat e gjyqit në 8 gjykata themelore në të katër zonat e apelit, me fokus kryesor në Njësinë e veçantë për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin në Gjykatën Themelore Penale në Shkup. Për këtë qëllim u angazhuan 16 vëzhgues profesionalë, juristë me eksperiencë shumëvjeçare dhe të cilët kanë njohuri më të detajuara të materies së të drejtës penale. Për qëllimet e hulumtimit u organizua një trajnim njëditor për vëzhguesit, dhe më pas ata u shpërndanë dhe morën pjesë në sallat e gjykatave në cilësi të publikut. Vëzhguesit u udhëhoqën nga parimet e objektivitetit dhe të mosndërrhyrjes, e po ashtu kishin për detyrë ta respektojnë dhe parimin e konfidencialitetit.


Përzgjedhja e lëndëve që u përfshinë në hulumtim u bë në mënyrë të rastësishme, edhe pse u bënë përpjekje për të përfshirë një mostër përfaqësuese, gjegjësisht të përfshihen procedura për vepra të ndryshme penale nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit, sipas përfaqësimit mesatar të veprave penale në procedurat gjyqësore të publikuara në raportet vjetore për punën e gjykatave, por edhe në analizat vjetore të Koalicionit.

Për nevojat e hulumtimit, është përgatitur një pyetësor i veçantë, i sistematizuar, në të cilin vëzhguesit i kanë futur të dhënat e mbledhura, dhe i cili përmban tregues shtesë për gjendjet konkrete të konstatuara në mënyrë që të bëhet një hulumtim më i hollësishëm i tyre. Pyetësi përbëhet nga pyetje që kishin të bënin me rrjedhën e shqyrtimit kryesor, me ç'rast ndiqej rrjedha e procedurës para gjykatës, ndërsa theksi u vu në disa prej instituteve karakteristike të kalimit nga procedura inkuizitore në procedurën akuzatore penale, por edhe për profilizimin e autorëve të këtij lloji të veprave penale. Pyetjet u konceptuan në mënyrë që mundësojnë përfshirjen e indikatorëve cilësorë dhe sasiorë për shkallën e zbatimit të LPP-së, por edhe të dokumenteve të ratifikuara ndërkombëtare, që e rregullojnë të drejtën për gjykim të drejtë. Pyetjet e mbyllura që ofrojnë dy ose më shumë përgjigje janë pjesa dominuese e pyetësorit dhe ato mundësojnë përpunimin më adekuat kompjuterik dhe statistikor të tendencave të caktuara të vërejtura si problematike ose pozitive gjatë zbatimit të LPP-së. Këto pyetje janë plotësuar me disa pyetje të hapura, ku vëzhguesit kishin mundësi t'i sqarojnë në mënyrë përshkruese disa përgjigje, t'i japin pikëpamjet e tyre, si dhe të shënojnë fakte për të cilat nuk është paraparë ndonjë pyetje konkrete në pyetësor. Në këtë mënyrë, u mundësua përfshirja e më shumë treguesve cilësorë të procedurës, në mënyrë që të dhënat që merren nga ana e vëzhguesve të japin një pasqyrë të qartë, të drejtpërdrejtë, objektive dhe transparente të lëndës penale ose shqyrtimit që i nënshtrohen monitorimit.

Pas mbledhjes së këtyre të dhënave, ato u futën në bazën kompjuterike të të dhënave, e më vonë u analizuan dhe u përpunuan për të nxjerrë konkluzione konkrete për situatën gjatë periudhës së monitorimit.

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME


Duke marrë parasysh se pjesa dominuese e veprave të kryera penale në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit procedohen në Shkup, gjegjësisht në Gjykatën Themelore Penale, për qëllimin e këtij hulumtimi u bë përpjekje që të mbulohen edhe disa nga gjykatat e tjera në vend, që merren me raste që kanë elemente të korrupsionit. Në këtë kuptim, aktivitetet e planifikuara të projektit u shpërndanë përmes rrjetit të krijuar vëzhguesve, i cili përfshinte tetë gjykata reprezentative themelore nga të katër zonat e apelit, gjegjësisht gjykatat në Shkup, Veles, Gostivar, Manastir, Prilep, Shtip, Strugë dhe Kumanovë. Në kuadër të këtij procesi u vëzhguan gjithsej 328 seanca gjyqësore. Numri më i madh i shqyrtimeve, gjegjësisht lëndëve, duke pasur parasysh edhe madhësinë dhe vëllimin e punës, janë vëzhguar në Gjykatën Themelore Penale në Shkup - 253, Veles - 6, Gostivar - 1, Manastir - 17, Prilep - 18, Shtip - 15, Strugë - 4, dhe Kumanovë - 14 (grafiku nr.1). Në aspekt kohor, monitorimi zgjati 7 muaj, duke filluar nga muaji prill i vitit 2019 e deri në fund të nëntorit të vitit 2019, me qëllim që të mblidhen sa më shumë të dhëna nga të cilat do të mund të nxirreshin përfundime, udhëzime dhe rekomandime.



Grafiku nr.1


Siç u theksua edhe në pjesën hyrëse të kësaj analize, subjekt i monitorimit ishin rastet nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit, që do të thotë një diapazon më i ngushtë i krimeve. Tani më nuk kemi vepra penale të krimit të dhunshëm ose krimeve të pronës, por të krimit financiar dhe të krimit të kryer nga grupe të strukturuar të përbëra prej tre ose më shumë personave, të cilat ekzistojnë një periudhë të caktuar kohore dhe që veprojnë për të kryer vepra penale. Në bazë të kësaj, edhe rezultati i marrë gjatë përpunimit të të dhënave tregon se nga ky grup i veprave penale, vepra më e shpeshtë penale është "Keqpërdorimi i detyrës zyrtare dhe autorizimit". Menjëherë pas tij vijnë "Prodhimi i paautorizuar dhe lëshimi në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve", "Ndërmjetësimi i kundërligjshëm", "Shoqërimi kriminal", "Trafiku me emigrantë" dhe të ngjashme. Në paraqitjen grafike nr. 2 janë dhënë veprat penale të regjistruara më shpesh në kuadër të procedurave të ndjekura në të gjitha 8 gjykatat në vend, pa e shprehur përqindjen dhe përfaqësimin e parëndësishëm të disa prej veprave të tjera penale, e që janë të përfshira në Kodin Penal në kapitujt Vepra penale kundër detyrës zyrtare, Vepra penale kundër shëndetit të njeriut, Vepra penale kundër financave publike, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë, Vepra penale kundër shtetit, Vepra penale kundër jurispruencës, Vepra penale kundër rendit publik, etj.

## ANALIZË e të dhënave nga vëzhgimi i procedurave gjyqësore në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit në vitin 2019



Grafiku nr.2

Nëse i analizojmë të dhënat përmes një qasje krahasuese në aspekt të gjykatave, do të vërejmë një përfaqësim identik të veprave penale në gjykatën në Shkup. Konkretisht, në Njësinë për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin në Gjykatën Themelore Penale në Shkup, vëllimi më i madh i lëndëve që procedohen janë mu ato që, pa dyshim, janë më të përfaqësuara në të dhënat e përpunuara - veprat penale sipas nenit 353, nenit 215 dhe nenit 418-b të Kodit Penal.




Grafiku nr.3


Kur bëhet fjalë për karakteristikat individuale të kryerësve të veprave penale, gjatë përgatitjes së qasjes metodologjike, ishte veçanërisht e rëndësishme të përcaktohet edhe moshja e kryerësve, niveli i arsimimit të tyre, si dhe pozita e tyre e punës. Kështu, nga të dhënat e përpunuara, e që shihet qartë në pamjet grafike të paraqitura më poshtë, mund të konstatohet se grupmosha më e përfaqësuar është ajo e moshës prej 41 deri në 50 vjet, ndërsa kur bëhet fjalë për nivelin e arsimimit, autorët janë njerëz me arsim të lartë, të cilët zakonisht janë pjesëtarë të pushtetit ekzekutiv, gjegjësisht punojnë në qeveri ose në ndonjërin prej ministrive. Në vetë procesin e monitorimit, ishte i pashmangshëm monitorimi i këtyre procedurave, sepse ato tërhoqën vëmendje të madhe të mediave, kishin rëndësi të madhe për publikun, por ishin edhe shembull adekuat i procedurave gjyqësore, përmes të cilave mund të analizohet në mënyrë krahasuese qasja dhe veprimet e gjykatës në krahasim me procedurat e tjera në këtë fushë.




## ANALIZË e të dhënave nga vëzhgimi i procedurave gjyqësore në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit në vitin 2019



Grafiku nr.4



Grafiku nr.5



Grafiku nr.6


## KUSHTET PËR MBAJTJEN E SEANCËS

Ligji për Procedurën Penale përcakton pjesëmarrjen e detyrueshme të disa prej palëve në procedurë dhe pa praninë e tyre, në parim, nuk ka mundësi të mbahet shqyrtimi. Personat, prania e të cilëve pritet dhe është e detyrueshme në shqyrtimin kryesor thirren nga gjykata, mirëpo, propozimi për atë se konkretisht cilët persona do të thirren nga gjykata, e për të cilët ligji nuk ka efekt detyrues, siç janë dëshmitarët, ekspertët, këshilltarët teknikë etj., është disponueshmëria e secilës nga palët. Konkretisht, pa sugjerimin e tyre dhe pa propozim për thirrje, gjykata nuk ka detyrim t'i thërrasë këta persona. Detyrimi i gjykatës për thirrjen e personave të caktuar vlen për të akuzuarin, mbrojtësin e tij (sipas zgjedhjes së tij ose që është emëruar sipas detyrës zyrtare), paditësin e autorizuar (qoftë ai prokuror publik apo paditës privat), si dhe për palën e dëmtuar me përfaqësuesin e saj ligjor, gjegjësisht personin e autorizuar.

Në mungesë të personave, prania e të cilëve është e domosdoshme për mbajtjen e shqyrtimit, gjykata patjetër duhet ta shtyjë atë. Kur i analizojmë të dhënat e përgjithshme nga viti 2019, është reg-

jistruar një shkallë e lartë e shtyrjes së shqyrtimeve gjyqësore - 61%, por nëse bëhet një analizë më e thellë dhe ndarje e të dhënave të përpunuara nga Gjykata Themelore Penale në Shkup (GjThPSh) dhe gjykatat e tjera që merren me lëndë të kësaj fushe, mund të shihet se kjo përqindje e përgjithshme e shqyrtimeve të shtyra (61%) nuk korrespondon me përqindjen e shqyrtimeve të shtyra në Njësinë për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin në GjThP - Shkup. Në fakt, gjatë procesit të monitorimit të kryer në këtë njësi në vitin 2019, në periudhën përkatëse kohore gjatë së cilës janë monitoruar gjithsej 177 shqyrtime në 81 lëndë, është regjistruar një shifër prej 49% të shqyrtimeve të shtyra. Kjo tregon se ka një ndryshim të konsiderueshëm nga përqindja e përgjithshme, e veçanërisht nëse merret parasysh fakti se nga numri i përgjithshëm i shqyrtimeve të monitoruara - 328, nga të cilat 253 janë në Shkup, në këtë njësi janë monitoruar 177 shqyrtime ose 54% nga numri i përgjithshëm i shqyrtimeve të monitoruara.

Kjo përqindje e lartë prej 61% e shqyrtimeve të shtyra korrespondon plotësisht me statistikën e shqyrtimeve të shtyra në nivelin e të gjitha zonave të apelit në vend për vitin 2018 dhe 2017, të cilat i përfshinin të gjitha procedurat penale, pavarësisht nga fusha tematike e ndjekjes penale. Megjithatë, siç mund të shihet edhe nga paraqitja grafike më poshtë, ka një trend të rritjes drastike të shqyrtimeve të shtyra në krahasim me vitet e kaluara (2015 dhe 2016), kur kjo përqindje, praktikisht, ka qenë 50% më e ulët se dy vitet e ardhshme.




Grafiku nr.7


Statistikat e shqyrtimeve të shtyra në lëndët me maturi penale, në të 4 zonat e apelit

Kur bëhet fjalë për shkaqet e shtyrjes, e të cilat kanë të bëjnë me mungesën e personave në procedurë, ajo që le më shumë përshtypje është mungesa e të akuzuarve në procedurë, por nuk është për t'u nënvlerësuar as mungesa e përfaqësuesve të Prokurorisë publike. Paraqitja grafike nr. 8 e tregon pikërisht përfaqësimin e mungesave të personave konkretë në procedurë. E shprehur në përqindje, kjo e dhënë statistikore tregon se mungesa e të akuzuarve në procedurë është regjistruar në 33% të rasteve, mungesa e Prokurorit Publik në 17%, mungesa e dëshmitarëve në procedurë në 17%, këshilli jo i plotë gjyqësor ka qenë vendimtar për shtyrjen e 14% të shqyrtimeve, ndërsa mungesa e ekspertit është regjistruar në 6% të rasteve. Në grafikun e mëposhtëm, nr.9, është dhënë një paraqitje krahasuese e mungesave të personave në procedurat në GjThP - Shkup dhe në gjykatat e tjera në vend, nga i cili në mënyrë të pashmangshme mund të konkludohet se edhe këto numra e ndjekin analogjinë e përpunimit të përgjithshëm statistikor, duke marrë parasysh se 77% e shqyrtimeve janë monitoruar në Gjykatën Themelore Penale në Shkup.

## ANALIZË e të dhënave nga vëzhgimi i procedurave gjyqësore në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit në vitin 2019



Grafiku nr.8



Grafiku nr.8


Ajo që ka qenë veçanërisht e dukshme në dy vitet e fundit, pavarësisht se a bëhet fjalë për lëndë nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit apo për ndonjë lëndë tjetër penale, është se gjithnjë e më shpesh evidentohet edhe këshill jo i plotë gjyqësor në shqyrtime. Në fakt, në vitin 2019, në 42 shqyrtime, është regjistruar këshill jo i plotë gjyqësor, nga të cilat në 24 raste bëhet fjalë për këshill gjyqësor në GjThP - Shkup, ndërsa në 18 rastet e tjera për gjykatat e tjera në vend. Në pjesën dominuese të rasteve kur bëhet fjalë për këtë çështje, ndërsa e njëjta është konstatuar edhe në GjThP - Shkup, në Njësinë për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin, kryesisht, bëhet fjalë për lëndë në të cilat kryetari i këshillit dhe gjyqtarët që janë anëtarë të këshillit, janë gjyqtarë që merren me lëndët e njëjta. Do të thotë, të njëjtit paraqiten në mënyrë alternative në një lëndë si kryetar i këshillit, e në një lëndë tjetër si anëtar i këshillit, kështu që në kushte të caktimit të shpeshtë të shqyrtimeve të lëndëve, ndonjëherë edhe disa herë brenda një jave pune, ata nuk janë në gjendje të arrijnë të jenë të pranishëm në të gjitha gjykimet e caktuara. Vetëm në kuadër të Njësisë për Krim të Organizuar dhe Korrupsion pranë GjThP - Shkup, në vitin e kaluar janë regjistruar 12 raste ku si arsye kryesore për shtyrjen e shqyrtimeve gjyqësore është pikërisht përbërja jo e plotë e këshillit gjyqësor.

Për t'i riparuar dëmet e mundshme nga kjo përputhje e angazhimeve të anëtarëve të këshillave, por edhe mungesat e arsyeshme për shkak të arsyeve shëndetësore ose për ndonjë arsye tjetër subjektive nga ana e këtyre personave, në përgjithësi, në nenin 349 të LPP-së është paraparë mundësia e angazhimit, gjegjësisht caktimit të gjyqtarëve shtesë dhe gjyqtarëve-porotë, për shkak të pengesës për të vepruar për çfarëdo qoftë arsye shtesë të ndonjë anëtari të këshillit në kuadër të një lënde konkrete. Konkretisht, nëse ka mundësi që shqyrtimi kryesor të zgjasë më shumë, kryetari i këshillit mund të kërkojë nga kryetari i gjykatës që të caktojë një ose dy gjyqtarë, gjegjësisht gjyqtarë-porotë, të marrin pjesë në shqyrtimin kryesor, që t'i zëvendësojnë anëtarët e këshillit në rast të pengesës së tyre. Kjo për shkak se kryetari i këshillit, gjyqtarët që janë anëtarë të këshillit dhe gjyqtarët-porotë duhet të marrin pjesë në vazhdimësi në shqyrtimin kryesor, kështu që nëse ndodh ndonjëra nga rrethanat e mësipërme gjatë së cilës ndonjë gjykatës i caktuar ose gjykatës porotë, nuk mund të marrë pjesë më tej në punën e këshillit, ai do të zëvendësohet nga një anëtar i përkatës shtesë. Ligji përcakton anëtarët shtesë të këshillit, janë prezent dhe marrin pjesë në shqyrtimet kryesore, por nuk marrin pjesë në të

njëjtën dhe nuk kanë të drejtat e anëtarit të këshillit derisa nuk paraqitet nevoja për ta zëvendësuar ndonjërin nga gjykatësit ose gjykatësit porotë i cili është i penguar që metutje të marrë pjesë në shqyrtimin kryesor, nga ku ata marrin pjesë me të gjitha të drejtat si një anëtar i këshillit”. Kjo mundësi është në përputhje me dispozitat për nxjerrjen e drejtpërdrejtë të provave, që është e domosdoshme në procedurën penale, por edhe vazhdimësi e shqyrtimit kryesor.

Në GjThP - Shkup, në Njësinë për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin, deri më tani në dy raste është vërejtur një praktikë pozitive e përdorimit të këtij mekanizmi - angazhimi i të ashtuquajturve gjyqtarë dhe gjyqtarë-porotë “rezervë”. Bëhet fjalë për rastet "Tarifa" dhe "Titanik" të iniciuara nga Prokuroria Speciale Publike, ku kryetarët e këshillave kanë kërkuar dhe është miratuar kërkesa e tyre për përfshirjen e personave shtesë, në përputhje me nenin 349 të LPP-së.

Megjithëse njëra nga arsyet për shtyrjen e shqyrtimeve është mungesa e të akuzuarve në procedurë, LPP-ja ofron mundësi, natyrisht, nëse përmbushen kushtet, që gjykata të gjykojë edhe në mungesë të të akuzuarit. Kështu, nga numri i përgjithshëm i shqyrtimeve të vëzhguara për vitin 2019, vëzhguesit vunë në dukje se në 17% të lëndëve gjykata ka vepruar, gjegjësisht ka gjykuar, në mungesë të të akuzuarit.




Grafiku nr.10

## E DREJTA PËR AVOKAT MBROJTËS

Një nga të drejtat themelore të personave të akuzuar në procedurë është e drejta për avokat mbrojtës. Ligji i procesit që zbatohet gjatë ndjekjes penale të autorëve të dyshuar të veprave penale përcakton se çdo person i dyshuar ose i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë për avokat mbrojtës gjatë gjithë procedurës penale që zhvillohet kundër tij. Kjo e drejtë e të akuzuarve vlen për gjithë procedurën, duke filluar nga marrja e parë në pyetje e të akuzuarit e deri në përfundimin e plotfuqishëm të procedurës, me atë që ligji le mundësinë që në raste të caktuara specifike kjo e drejtë të forcohet deri në atë shkallë sa që, nëse personi nuk ka avokat të vetin mbrojtës, gjykata ia cakton një avokat mbrojtës sipas detyrës zyrtare.

Duke i marrë parasysh rrethanat në të cilat janë kryer veprat që janë monitoruar tematikisht vitin e kaluar, kompleksitetin e tyre, e me këtë edhe mundësia për t'u përballë me dënime të larta për këtë lloj të veprave penale, nga të dhënat e mbledhura mund të konkludojmë se, në pjesën më të madhe, të akuzuarit në procedura kishin avokatët e tyre mbrojtës. Në një pjesë krejtësisht të papërfillshme të procedurave, të akuzuarve u janë caktuan avokatë mbrojtës sipas detyrës zyrtare, ndërsa në vetëm 4 raste të akuzuarit ishin pa avokat mbrojtës në shqyrtimin kryesor.



Grafiku nr.11

## MASAT PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË AKUZUARIT

Të dhënat për zbatimin e masave për sigurimin e pranisë së të akuzuarve janë pjesë përbërëse e analizës, sepse përmes aplikimit të tyre adekuat dhe joselektiv mund të ndikohet në masë të madhe në vlerësimin e shkallës së drejtësisë së një procedure penale. Në përputhje me praktikatat e vitit të kaluar, edhe këtë vit objekt i monitorimit nga vëzhguesit tanë ishte shpeshësia e të gjitha masave për sigurimin e pranisë sipas nenit 144 të LPP-së, me fokus të veçantë në masën më të vështirë për sigurimin e pranisë - paraburgimin, e cila më së shumti e prek të drejtën e lirisë së të akuzuarve gjatë procedurës penale. Në këtë drejtim, përveç numrit të masave të aplikuara dhe mënyrës së zbatimit të tyre, zbulohen edhe arsyet e aplikimit të tyre, si dhe shqyrtohet në mënyrë kritike se sa janë mbështetur gjyqtarët në mënyrë adekuate në prova gjatë marrjes së vendimeve për zbatimin e këtyre masave.

Duke i analizuar të dhënat nga lëndët e vëzhguara për aplikimin e masave për sigurimin e pranisë së personave të akuzuar në krahasim me vitin e kaluar, mund të konstatojmë se, këtë vit, Koalicioni ka monitoruar për 1/3 numër më të vogël të seancave dhe të lëndëve penale, gjegjësisht janë vëzhguar gjithsej 328 seanca në 191 lëndë, për dallim na viti i kaluar ku janë vëzhguar 415 seanca në 300 lëndë<sup>3</sup>. Me këtë rast, nga këto 191 lëndë, paraburgimi është zbatuar për 12 të akuzuar në 9 lëndë. Nëse këto numra krahasohen me vitin e kaluar nga 29 të akuzuar në 29 raste paraburgimi, mund të nxirret përfundimi se ka rënie serioze të numrit të të akuzuarve të arrestuar nga lëndët e zgjedhura rastësisht që janë monitoruar. Në fakt, korrelacioni i thjeshtë flet për rënie të numrit të lëndëve të vëzhguara me masë të paraburgimit për pak më shumë se 50% të lëndëve dhe për pothuajse 60% të personave të akuzuar të arrestuar.

Megjithatë, se nuk bëhet fjalë për rënie serioze në numrin e lëndëve me masë të paraburgimit në krahasim me vitin e kaluar, konfirmon qasja krahasuese sa i përket numrit të përgjithshëm të rasteve të vëzhguara gjatë vitit të kaluar me numrin e këtij viti, kështu që, për dallim nga viti i kaluar kur masa e paraburgimit është përcaktuar në 6.7% të seancave të vëzhguara, këtë vit kemi zbatim të masës së paraburgimit në 4.7% të seancave të vëzhguara. Më në fund, numri ose përqindja e vërtetë e personave të paraburgosur fitohet nëse krahasohet numri i personave të paraburgosur me numrin e përgjith-

3 Shih: Misoski B., Avramovski D., Petrovska N., Analiza e të dhënave nga procedurat e vëzhguara gjyqësore në vitin 2018, Misioni i OSBE në Shkup, vitit 2019.

shëm të personave të akuzuar në të gjitha lëndët e vëzhguara. Kështu, për dallim nga viti i kaluar, kur përqindja e personave të akuzuar të paraburgosur në krahasim me numrin e përgjithshëm të personave të akuzuar në të gjithë lëndët penale ishte 4.7%, gjegjësisht nga 611 persona të akuzuar, vetëm 29 persona kanë qenë në paraburgim, këtë vit kjo përqindje është 8.1%, gjegjësisht në paraburgim kanë qenë vetëm 12 nga 148 persona të akuzuar në lëndët e lidhura me korrupsion dhe krim të organizuar.


Këto të dhëna, në të vërtetë, na çojnë në përfundimin se këtë vit kemi një rritje të lehtë të zbatimit të masës së paraburgimit në krahasim me vitin e kaluar. Megjithatë, këtë numër nuk duhet ta interpretojmë me shqetësim për dy arsye.

Arsyeja e parë është se në krahasim me vitin e kaluar nuk mund të konkludojmë se kemi rritje drastike të zbatimit të masës së paraburgimit, sepse edhe me këtë përqindje të personave të paraburgosur në krahasim me numrin e përgjithshëm të personave të akuzuar, sistemi i të drejtës penale në Maqedoninë e Veriut është madje në kufirin e poshtëm në kuadër standardeve evropiane ku përqindja e personave të paraburgosur në krahasim me të gjithë të akuzuarit është nën 10%<sup>4</sup>.

Argumenti i dytë, i cili është edhe më i rëndësishëm se i pari dhe i cili e shpjegon drejtpërdrejt rritjen e zbatimit të masës së paraburgimit, është analiza e llojit të veprave penale të cilat vëzhgohen dhe analizohen nga Koalicioni. Në fakt, për dallim nga viti i kaluar kur objekt i analizës ishin të gjitha veprat penale që gjykohen para gjykatave themelore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, pavarësisht nga lloji i veprës penale, këtë vit analiza është përqendruar vetëm në lëndët e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Sipas kësaj, gjegjësisht duke e marrë parasysh llojin e krimit me të cilin merret analiza e këtij viti, rritja e përqindjes së personave akuzuar të paraburgosur është plotësisht e justifikuar. Nga ana tjetër, se këto numra nuk janë problematikë, gjegjësisht se bëhet fjalë për të dhëna të sakta nga zgjedhja e rastësishme e lëndëve, të cilat në masë të madhe mund ta pasqyrojnë situatën reale që është e pranishme në gjykatat anembanë vendit, flet edhe fakti se kjo përqindje prej 8.1% në lëndët të lidhura me krimin e organizuar dh korrupsion të vëzhguara në vitin 2019 në krahasim me 4.7% në lëndët penale për arsye të ndryshme penale të vëzhguara në vitin 2018, nuk mund të interpretohet si rritje e ndjeshme ose e konsiderueshme (shih Grafikon nr.12).

4 Shih: <https://ec.europa.eu/eurostat/data/database> ose te: van Kalmthout, AM, Knapen, MM dhe Morgenstern, C., ed. Pre-trial Detention in the European Union, WLP, 2009, fq. 55-56.

## ANALIZË e të dhënave nga vëzhgimi i procedurave gjyqësore në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit në vitin 2019




Grafiku nr.12

(Masat për sigurimin e pranisë dhe veprat penale për të cilat janë caktuar ato)


Sipas këtyre të dhënave, mund të konkludojmë se shumica e masave për sigurimin e pranisë janë përcaktuar për veprën penale nga neni 215 i Kodit Penal - Prodhimi i paautorizuar dhe lëshimi në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve, dhe nga dy për veprat penale nga neni 353 i Kodit Penal - Keqpërdorimi i detyrës zyrtare dhe autorizimit dhe nga neni 396 i Kodit Penal - Dhunë dhe nga një i akuzuar në paraburgim për veprat penale nga neni 418-a i KP-së - Tregti me njerëz, 418-b i KP-së - Kontrabanda me emigrantë dhe 418-g i KP-së - Tregti me fëmijë. Duke i marrë parasysh veprat penale, nuk mund të komentojmë për ashpërsinë dhe/ose arsyetimin e gjykatës vetëm për sa i përket llojit të veprave penale, sepse në këto raste bëhet fjalë për krim të rëndë për të cilin, në varësi të karakteristikave personale të autorëve, zbatimi i masave më të rrepta për sigurimin e pranisë, më shpesh, është i arsyeshëm.

Nga të dhënat e regjistruara nga seancat e vëzhguara mund të konkludohet një rënie serioze sa i përket zbatimit të masave më të lehta për sigurimin e pranisë së të akuzuarit. Kështu, për dalim nga viti i kaluar kur këto masa u përcaktuan në 31 lëndë, këtë vit këto masa u përcaktuan në vetëm 12 lëndë (shih Grafikon nr.13).



Grafiku nr.13  
(Masat për sigurimin e pranisë)

Aq më tepër pasi që këtë vit nga masat më të lehta për sigurimin e pranisë, masat parandaluese janë përcaktuar vetëm për 22 persona, nga të cilët për 9 persona është zbatuar detyrimi për të akuzuarin që të paraqitet herë pas here tek personi i caktuar zyrtar ose në organin kompetent shtetëror, ndërsa për 13 persona, u përcaktua masa e konfiskimit të përkohshëm të pasaportës ose ndonjë dokumenti tjetër për kalimin e kufirit shtetëror, gjegjësisht ndalimi për lëshimin e saj/tij. Në fund, paraburgimi shtëpiak u përcaktua për dy të akuzuar në dy raste. Për fat të keq, këtë vit garancia nuk është vërejtur në asnjërin prej lëndëve të zgjedhura rastësisht që u vëzhguan. Përmes këtyre të dhënave për aplikimin e masave më të lehta për sigurimin e pranisë së të akuzuarit, në fakt, jemi më afër numrave të dy viteve më parë<sup>5</sup> për aplikimin e masave më të lehta për sigurimin e pranisë së personave të akuzuar gjatë procedurës penale (shiko Grafikon nr.14).



Grafiku nr.14  
(Masat parandaluese)

Duke i pasur parasysh vetëm të dhënat për zbatimin e masave për sigurimin e pranisë së personave të akuzuar në përputhje me të dhënat nga rastet e vëzhguara, mund të konstatojmë se gjykatat tona në masë të madhe e respektojnë të drejtën e lirisë të personave të akuzuar, gjegjësisht në masë të madhe e respektojnë parimin e supozimit të pafajësisë në krahasim me zbatimin e masave që e cenojnë seriozisht të drejtën e tyre të lirisë që është e garantuar me kushtetutë<sup>6</sup>. Me këtë, mund ta përsërisim kënaqësinë e vitit të kaluar për përmbajtjen nga ana e gjykatës për zbatimin e masave për sigurimin e pranisë së të akuzuarit, gjegjësisht mund të konstatohet se gjykatat tona në lëndët e krimit të organizuar dhe korrupsionit e respektojnë plotësisht të drejtën e lirisë së të akuzuarve.

Megjithatë, këndvështrimi i këtyre ndaj këtyre masave është, deri diku, i njëanshëm, sepse ky interpretim nuk e merr parasysh qëllimin e ekzistimit të këtyre masave, gjegjësisht duke e favorizuar të

5 Shih: Misoski B., Avramovski D., Petrovska N., Analiza e të dhënave nga procedurat e vëzhguara gjyqësore në vitin 2017, Misioni i OSBE në Shkup, viti 2018.

6 Shih: Josipović Ivo, Uhićenje i pritvor, Targa, Zagreb, 1998, fq. 38-40, si dhe Tombs Jacqueline and Jagger Elizabeth, Denying Responsibility, Sentencers' Accounts of their Decisions to Imprison, British Journal of Criminology, 2006, (803-821), fq. 810.



drejtën e të akuzuarit për liri e injorojmë të drejtën për gjykim efikas dhe veprim efektiv. Në fakt, nëse merret parasysh përqindja e lartë e seancave të shtyra për shkak të mungesës së të akuzuarit, duket se efikasiteti i sistemit të drejtësisë penale në rastet tona nuk mund të mbështetet në zbatimin e masave për sigurimin e pranisë. Me fjalë të tjera, mund të konkludojmë se, për fat të keq, gjyqtarët, jo rrallë, shumë lehtë i shtyjnë seancat gjyqësore në të cilat mungon i akuzuari dhe gjatë vlerësimit të shkaqeve për mungesën e të akuzuarit, shpesh herë, duket se kanë, ndoshta edhe mirëkuptim të tepërt për gjendjen e të akuzuarit, dhe me këtë rast nuk zbatojnë masa më të rrepta për ta siguruar praninë e tij. Mu për këtë arsye, konsiderojmë se përqindja e lartë e seancave të shtyra mund të zvogëlohet deri diku edhe me aplikimin më të shpeshtë të masave më të lehta për sigurimin e pranisë së të akuzuarit, edhe atë përmes kombinimit adekuat të tyre mund të krijohet cilësi dhe sasi e përshtatshme për ta detyruar të të akuzuarin të marrë pjesë rregullisht në seancat gjyqësore, me ç'rast zbatimin e masave për sigurimin e pranisë së të akuzuarit nuk do të kishte karakter ndëshkues.

Një konkluzion tjetër është se gjyqtarët nuk kanë fonde të mjaftueshme dhe mjete të procesit me anë të të cilave do të mund të verifikonin nëse i akuzuari me të vërtetë mungon me arsye apo thjesht e manipulon gjykatën, dhe mbi këtë bazë edhe gjyqtarët do të mund ta bazonin vendimin e tyre për zbatimin më të shpeshtë të masave për sigurimin e pranisë së të akuzuarve gjatë procedurave penale. Mu për këtë arsye, konsiderojmë se është e nevojshme të riaktualizohet përfundimi i vitit të kaluar për ndryshime ligjore përmes të cilave do të futej një shërbim i veçantë në sistemin e drejtësisë penale, i cili do t'ua jepte këto të dhëna gjyqtarëve për profilin e personit të akuzuar. Njëra nga mënyrat për zbatimin e këtij rekomandimi është ndryshimi dhe përmirësimi i Ligjit për Shërbimin e Provës, me ç'rast zyrtarëve të Shërbimit të provës do t'u jepeshin këto kompetenca për t'i ndihmuar gjyqtarët, të cilët në esencë janë të afërta me kompetencat aktuale të zyrtarëve të Shërbimit të provës për të bërë vlerësime të rrezikut për personat e dënuar dhe të akuzuar sipas nenit 11 të Ligjit për Shërbimin e Provës<sup>7</sup>. Kuptohet, këto ndryshime ligjore do të kërkonin në mënyrë të pashmangshme edhe një rritje të konsiderueshme të kapaciteteve njerëzore dhe materiale të Shërbimit të provës, për të cilën mund të konstatojmë me kënaqësi se dalëngadalë po fillon ta ushtrojë kompetencën dhe funksionin e tij ligjor.

Argumente të ngjashme në lidhje me ekzistimin e një shërbimi të veçantë për t'i ndihmuar gjyqtarët në krijimin e profilit social të të akuzuarit mendojmë se janë të vlefshme edhe për përcaktimin dhe zbatimin e masës së paraburgimit shtëpiak, i cili, për fat të keq, këtë vit shënon rënie në krahasim me 14 masat e vitit të kaluar, me ç'rast sivjet janë regjistruar 2 masa të tilla. Megjithatë, konsiderojmë se është për t'u lavdëruar fakti se në të paktën 2 raste gjykata gjeti fuqinë që ta zbatojë këtë masë më të lehtë për dallim nga viti 2017, kur kjo masë nuk u përcaktua asnjëherë<sup>8</sup>. Në këtë drejtim, konsiderojmë se është e nevojshme të riaktualizohet përfundimi i vitit të kaluar në lidhje me zbatimin adekuat të masës së paraburgimit shtëpiak dhe kufizimin e tij vetëm për disa kategori të caktuara njerëzish.

Këtë vit mund të jemi të kënaqur që ky problem është trajtuar siç duhet në ndryshimet dhe plotësimet e LPP-së, të cilat janë në fazën përfundimtare dhe gjenden në procedurë parlamentare. Por, për fat të keq ende nuk janë miratuar nga Parlamenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në lidhje me këtë mund të konstatojmë se në ndryshimet e propozuara ligjore në LPP, në tërësi janë pranuar edhe rekomandimet e Koalicionit në lidhje me kufizimin e zbatimit të paraburgimit shtëpiak vetëm për të

7 Gazeta Zyrtare e RM nr. 226/2015.

8 Shih: Misoski B., Avramovski D., Petrovska N., Analiza e të dhënave nga procedurat e vëzhguara gjyqësore në vitin 2017, Misioni i OSBE në Shkup. Viti 2018

moshuarit dhe të dobëtit, gratë shtatzëna dhe të akuzuarit me sëmundje kronike<sup>9</sup>, duke i marrë parasysh me këtë rast specifikat e sanksionit të paraburgimit shtëpiak në Kodin Penal.

Megjithatë, për fat të keq, ende nuk kemi ndërhyrje adekuate në dispozitat e Ligjit për Shërbimin e Provës dhe në LPP, ku në mënyrë adekuate do të parashiheshin dispozita për avancimin e zbatimit të masës së paraburgimit shtëpiak me mbikëqyrje elektronike, me anë të së cilës, eventualisht, do të mund të rritej dhe të përmirësohej zbatimi i kësaj mase. Duke u nisur nga aplikimi i ngjashëm i këtyre dy masave të ndryshme, konsiderojmë se masat për sigurimin e pranisë, paraburgimi shtëpiak dhe paraburgimi shtëpiak me mbikëqyrje elektronike do të duhej të vendosen nën kompetencën e zyrtarëve të Shërbimit të provës, në mënyrë që gjykatat të mund të jenë të sigurta në konfidencialitetin dhe përshtatshmërinë e zbatimit të këtyre masave.<sup>10</sup>

Pikërisht ngjashmëria në zbatimin praktik të masave më të lehta për sigurimin e pranisë dhe të sanksioneve alternative nga ana e organeve të hetuesisë, si dhe niveli i përgatitjes profesionale të zyrtarëve të Shërbimit të provës, na çon në përfundimin se, në kushtet kur ekziston një Shërbim i fortë i provës me autorizime të zgjeruara për ta ndihmuar gjykatën duke përgatitur profilin socio-ekonomik të të akuzuarit gjatë procedurës penale, masat më të lehta do të mund të zbatoheshin më shpesh se sa paraburgimi, e po ashtu do të mund të bëhej edhe një kombinim më i përshtatshëm dhe më efektiv i masave më të lehta, me zbatimin e të cilave nuk do të vihej në dyshim prania e të akuzuarit gjatë procedurës penale<sup>11</sup>.

Në lidhje me zbatimin e kufizuar ose moszbatimin e masës së garancisë, mund të ofrohen disa argumente, i pari prej të cilave është problemi tashmë i shtjelluar gjerësisht sa i përket disponueshmërisë së të dhënave për pasurinë e të akuzuarit, si dhe problemi me strukturën komplekse pronësore të pronës që depozitohet si garanci nga të akuzuarit se do të marrin pjesë në seancat gjyqësore. Për më tepër, konsiderojmë se nëse gjykata do të kishte të dhëna të mjaftueshme dhe adekuate për gjendjen e vërtetë të pronës së të akuzuarve, shpeshherë do të ishte e kënaqur edhe me shumica më të ulëta si garanci, të cilat në raste të caktuara do të ishin më të lehta për t'u realizuar në rast të mungesës së pajustificuar të të akuzuarve nga gjykimet. Në këtë mënyrë, nëse gjykata do të kishte njohuri të plotë për profilin financiar dhe personal të të akuzuarit kur vendos për garancinë, do të mund ta përcaktonte në mënyrë të pavarur dhe më të përshtatshme sasinë e garancisë. Me këtë, do të shmangej praktika kur të akuzuarit në propozimin për përcaktimin e garancisë shpeshherë gjykatës i propozojnë pronë shumë të madhe, por e cila është e vështirë për t'u transferuar ose pronë që është e vështirë për t'u realizuar në rast të arratisjes së të pandehurit, me ç'rast, faktikisht, kjo pronë nuk përbën asnjë garanci për gjykatën se i akuzuari do të paraqitet rregullisht në të gjitha seancat e shqyrtimit kryesor. Kjo për arsye të thjeshtë se në rast të arratisjes së të akuzuarit, prona e depozituar me një strukturë kaq të ndërlikuar të pronësisë, as gjykata, e as institucionet shtetërore nuk do të mund ta realizonin ose ta likuidojnë, për ta realizuar me të vërtetë kërcënimin në rast të dështimit të garancisë. Mu për këtë arsye, konsidero-

9 Po aty

10 Shih: Hucklesby Anthea and Marshall Emma, Tackling Offending on Bail, The Howard Journal, Vol. 39, No.2. May, 2000, fq. 150-170, ose Misoski B., Can Law on Probation Improve the Implementation of the Measures for Providing the Defendant's Presence in the Criminal Trials in the Republic of North Macedonia?, EU AND MEMBER STATES – LEGAL AND ECONOMIC ISSUES Vol 3 (2019). <https://hrcaak.srce.hr/ojs/index.php/eclic/index>


11 Për këtë, nga përvoja e vendit mund të shërbejë praktika gjyqësore në rastin "Perandoria" (Imperija), kur njëri prej të akuzuarve ankohet se zbatimi i masës parandaluese "Konfiskimi i përkohshëm i dokumentit të udhëtimit ose dokumentit tjetër për kalimin e kufirit shtetëror, përkatësisht ndalim për dhënie e tij", paraqet kufizim të tepërt të lirisë së tij dhe kërkon zëvendësimin e kësaj mase me garanci. Gjë që flet në favor të konkluzionit se nëse këto masa dozohen dhe planifikohen siç duhet, ato mund ta garantojnë në masë të madhe praninë e të akuzuarit gjatë procedurës penale, në vend që të zbatohet masa më e rreptë, të paktën sipas definicionit, ajo e paraburgimit.

## ANALIZË e të dhënave nga vëzhgimi i procedurave gjyqësore në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit në vitin 2019

jmë se për tejkalimin e enigmës aktuale në gjykatat vendase në zbatimin e garancisë, do të ndihmonte vendosja e kompetencës së veçantë për profilizim specifik të karakteristikave sociale dhe financiare të të akuzuarit, duke krijuar shërbime të veçanta qoftë në kuadër të Prokurorisë Publike, apo në kuadër të Shërbime të provës<sup>12</sup>.

Një argument shtesë në lidhje me (mos)zbatimin e garancisë është edhe fakti se kjo masë, për fat të keq, ende perceptohet si masë zëvendësuese e paraburgimit, kështu që garancia shpesh herë propozohet si zëvendësim i paraburgimit të përcaktuar fillimisht gjatë hetimit. Në këtë drejtim, konsiderojmë se kjo praktikë në një farë mënyre ka një efekt demotivues ndaj gjykatës për zbatimin e garancisë gjatë shqyrtimeve kryesore të vëzhguara, duke marrë parasysh faktin se gjykata tashmë ka vendosur një herë për përcaktimin e saj, mirëpo nga propozimi fillestar deri te propozimi i përsëritur nuk ka ndonjë ndryshim të madh në rrethanat faktike as te i akuzuari, as te faktet, e as në statusin e tij pronësor.

Lidhur me ndihmën efikase juridike të ofruar nga mbrojtësi i të akuzuarit, me kënaqësi mund të konstatojmë se këtë vit, të akuzuarit që ishin në paraburgim në të gjitha rastet kishin avokatin e tyre mbrojtës. Nga ana tjetër, në asnjë rast asnjëri prej të akuzuarve të paraburgosur nuk kishte mbrojtës të caktuar sipas detyrës zyrtare, që, në një farë mënyre, edhe mund të pritet, duke pasur parasysh profilin e personave të akuzuar në rastet e vëzhguara të krimit të organizuar dhe korrupsionit (shih Grafikon nr.15).



Grafiku nr.15  
(Prania e avokatit mbrojtës dhe paraburgimi)


12 Shih kompetencën e Shërbimeve të provës, për shembull, në Holandë ose në Francë, në: Van Kalmthout, AM, Durnesku, I., Probata në Evropë, fq. 23-30; ose në SHBA, Federal Pretrial Risk Assessment Instrument, User's Guide, Office for Probation and Pretrial Services, 2016. Gjetet në: <https://www.ncjrs.gov/> ose Cesaro Gianluca, "Probation officers are key actors in reforming pre-trial detention and ensuring effective cross-border justice in the EU", gjetet në: <http://cep-probation.org/probation-officers-are-key-actors-in-reforming-pre-trial-detention-and-ensuring-effective-cross-border-justice-in-the-eu/>

## KËSHILLAT PËR TË DREJTAT

Statusi i personit të akuzuar në procedurë, në masë të madhe, vetvetiu është specifik, veçanërisht nëse e marrim parasysh faktin se në procedurat penale personi kundër të cilit zhvillohet procedura përballlet me kufizim të lirisë së tij. Për ta mbrojtur personin e akuzuar nga veprimi arbitrar i organeve shtetërore në çdo fazë të procedurës, shteti garanton të drejta të caktuara të procesit dhe nëse ato nuk sigurohen, mund të shkelet e drejta e garantuar për gjykim korrekt dhe të drejtë.

Bazat për garancitë e procesit në procedurë përcaktohen në fazën kur personi i akuzuar njihet me përmbajtjen e aktakuzës dhe kualifikimin e veprës me të cilën akuzohet. Gjatë monitorimit të procedurave, vëzhguesit konstatuan se në 15% të rasteve (gjysma e të cilave ishin në GjThP - Shkup, ndërsa gjysma tjetër në GjTh - Kumanovë), të akuzuarit nuk u pyetën fare nga gjykata se a e kuptuan se për çfarë akuzoheshin.


Personi i akuzuar gëzon mbrojtje deri në atë shkallë sa që me ligj parashihet se nëse gjykata vepron në kundërshtim me dispozitat që parashohin këshillim të detyrueshëm për të drejtat, dëshmia e të akuzuarit nuk mund të përdoret gjatë procedurës gjyqësore. Kjo është arsyeja pse këshillat për të drejtat ishin objekt i analizës edhe këtë vit. Kështu, gjatë përpunimit dhe analizës së të dhënave të mbledhura nga vëzhguesit, konstatuam (Grafiku nr.16) se të drejtat për të cilat më shpesh këshillohen të akuzuarit janë, në fakt, e drejta për avokat mbrojtës, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për të heshtur, për dallim nga të dhënat e vitit të kaluar, të cilat tregonin se të drejtat më të përmendura ishin e drejta për të dëshmuar, e drejta për të paraqitur prova në mbrojtje të vetes, si dhe e drejta për të heshtur, dhe menjëherë pas kësaj, e drejta për vërejtje, respektivisht për avokat mbrojtës. Ajo që është identike me të dhënat nga viti 2018 është këshilla për të drejtën për përkthyes, e cila, qartazi, përdoret me kufizim, pavarësisht nga ajo se a bëhet fjalë për lëndë nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit apo për lëndë me maturi penale.



Grafiku nr.16  
(Këshillat për të drejtat)

Duke marrë parasysh sa raste janë monitoruar në GjThP - Shkup, e sa në qytetet e tjera, këshillat për të drejtat e kanë raportin e ngjashëm, me atë që e drejta për përkthyes dhe e drejta për të dhënë vërejtje, në gjykatat e tjera në vend, janë të drejtat për të cilat të akuzuarit janë këshilluar më së paku (shih Grafikon nr.17).


## ANALIZË e të dhënave nga vëzhgimi i procedurave gjyqësore në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit në vitin 2019




Grafiku nr.17

(Këshillat për të drejtat në GjThP - Shkup kundrejt gjykatave të tjera themelore)

Në komentin e LPP-së parashikohet se "Çdo këshillë që është përmendur në paragrafin 1 të nenit 206 të LPP-së, të akuzuarit duhet t'i tregohet veç e veç dhe atij duhet t'i jepet mundësia të deklarohet veç e veç për secilën të drejtë nga paragrafi 1 i këtij neni.<sup>13</sup>" Nëse ky interpretim i autorëve do të ishte pranuar nga gjyqtarët që e zbatojnë ligjin, grafiku nr.12 gjegjësisht 17, do t'i kishte përmbushur me 100 për qind të gjitha kategoritë e të drejtave të cilat janë të parapara, por meqenëse kjo nuk është kështu, mbetet që kjo çështje të trajtohet nga ata që punojnë në praktikë me qëllim të përmirësimit të gjendjeve në lidhje me këshillat për të drejtat. Megjithatë, të drejtat e të akuzuarve nuk nënkuptojnë vetëm përmendjen e tyre, por ato duhet edhe të shpjegohen në mënyrë që është e kuptueshme për të akuzuarin. Kjo është një situatë tjetër në të cilën, ndoshta, ka nevojë për ndërhyrje gjatë zbatimit të ligjit, pasi në 12% të rasteve, vëzhguesit kanë vërejtur se të drejtat e të akuzuarve nuk janë shpjeguar në mënyrë të duhur. Kjo do të thotë se ato nuk janë shpjeguar në mënyrë që është e kuptueshme për të akuzuarin (Grafiku nr.18). Po të shihet sipas gjykatave, kjo praktikë negative është regjistruar në Gjykatat Themelore në Manastir dhe Strugë dhe vetëm në një rast në GjThP - Shkup.



Grafiku nr.18



Grafiku nr.19

Megjithëse në pjesën e shpjegimit të të drejtave për të akuzuarin në gjuhë të kuptueshme ka një përmirësim të situatës në krahasim me vitin e kaluar, po të bëhet një krahasim me lëndët që kanë të bëjnë me veprat me maturi penale, në pjesën e mënyrës së shpjegimit të të drejtave vërejmë ngecje. Në

13 Kallajxhiev G., Llazhetiq G., Nedellkova L., Denkovska M., Trombeva M., Vitlarov T., Jankullovska P., Kadiev D., Koment i Ligjit për procedurën penale, OSBE, Shkup, 2018

fakt, në vitin 2017, përqindja e shpjegimit të të drejtave në gjuhë të kuptueshme për të akuzuarin ishte 93%, në vitin 2018, kjo përqindje ka rënë në 75%, ndërsa në vitin 2019 shohim përsëri një tendencë rritjeje prej 88%. Po ta analizojmë më thellë këtë çështje, në aspekt të diapazonit të shpjegimit, do të shohim se ka një përqindje të madhe të shqyrtimeve në të cilat gjyqtari vetëm i ka përmendur të drejtat (85%), ndërsa në një pjesë minimale (3%) të drejtat nuk janë shpjeguar fare. Kjo statistikë negative ka të bëjë me Gjykatën Themelore në Manastir, ku jo vetëm që janë regjistruar një numër i madh shqyrtimeve ku vetëm janë përmendur të drejtat, por edhe i shqyrtimeve ku ato nuk janë shpjeguar fare.

## ZBATIMI I PRANIMIT TË FAJIT

Procedura për pranimin e fajit gjatë shqyrtimit kryesor është një element i domosdoshëm i analizave të Koalicionit për gjykim të drejtë, me të cilat analizohet drejtësia e procedurave të vëzhguara<sup>14</sup>. Specifikat e procedurës penale në të cilat i akuzuari e ka pranuar fajin janë interesante për analizë, si nga pikëpamja teorike ashtu edhe nga pikëpamja praktike. Shkalla e respektimit të të drejtave të procesit të të akuzuarit në korrelacion me heqjen dorë në mënyrë të paravar nga ana e të akuzuarit nga një pjesë e garancive të procesit për gjykim të drejtë, e me këtë edhe ndikimi i një procedure të tillë të shkurtuar, shikuar përmes prizmit të ekonomisë së procesit dhe kursimit të burimeve gjyqësore dhe ndikimit të këtyre veprimeve të procesit, kanë një ndikim të konsiderueshëm në perceptimin e përgjithshëm të publikut për drejtësinë e procedurës penale. Aq më tepër kur kihet parasysh se ndikimi i pranimit të fajit nga i akuzuari mbi veprimet e tjera të procesit që ndërmerren gjatë procedurës penale, edhe atë kryesisht mbi provat dhe shkallën e provës, është i lidhur drejtpërdrejt edhe me shkallën e efikasitetit të drejtësisë penale.


Në lëndët e vëzhguara gjatë këtij viti, vëzhguesit tanë regjistruan vetëm 7 pranime të fajit nga ana e të akuzuarve. Këto të dhëna flasin për faktin se pranimi i fajit gjatë shqyrtimit kryesor po bëhet gjithnjë e më i rrallë në rastet e vëzhguara. Në fakt, për dallim nga 40 pranimet e fajeve të regjistruara në vitin 2017<sup>15</sup> dhe 26 në 2018<sup>16</sup>, këtë vit, për fat të keq, vëzhguesit tanë kanë dëshmitarë të vetëm 7 pranimeve të fajit nga të akuzuarit gjatë shqyrtimit kryesor. Një rënie e këtillë eksponenciale e pranimit të fajit nga të akuzuarit gjatë shqyrtimit kryesor paralajmëron një problem të mundshëm sistematik sa i përket zbatimit të këtij instituti në procedurën penale.

14 Procedurë që njihet në shumë legjislacione nëpër botë, si dhe nga ana e Këshillit të Evropës përmes Rekomandimit Nr. (87) 18, të Komitetit të Ministrave të Vendeve Anëtare lidhur me Thjeshtësimin e Drejtësisë Penale. Shih edhe: Buzharovska G., Misoski B., Plea Bargaining under the CPC of the Republic of Macedonia, në Simplified Forms of Procedures in Criminal Matters – Regional Criminal Procedure Legislation and Experiences in Application, Ivan Jovanovic and Mirosljub Stanisavljevic eds., OSCE Mission to Serbia, 2013

15 Shih: Misoski B., Avramovski D., Petrovska N., Analiza e të dhënave nga procedurat e vëzhguara gjyqësore në vitin 2017, Misioni i OSBE në Shkup. Viti 2018

16 Shih: Misoski B., Avramovski D., Petrovska N., Analiza e të dhënave nga procedurat e vëzhguara gjyqësore në vitin 2018, Misioni i OSBE në Shkup. viti 2019

Numri i pranimit të fajit sipas veprave penale



Grafiku nr.20

Në fakt, përkundër parakushteve të evidentuara negative për rënien e numrit të pranimit të fajit nga ana e të akuzuarve gjatë shqyrtimit kryesor, siç është për shembull, heqja e parashikueshmërisë së sanksionit penal që u interpretua si epilog i dëshiruar me heqjen e Ligjit të kritikuar gjerësisht<sup>17</sup> dhe të papërgatitur si duhet për përcaktimin e llojit dhe lartësisë së sanksionit penal, me sa duket kjo praktikë e mos përdorimit të pranimit të fajit nga i akuzuari gjatë procedurave gjyqësore është duke marrë përmasa problematike. Kështu, me sa duket, mund të përmenden dy arsye për mos përdorimin e këtij instituti.

Fillimisht, një arsye e qartë për të mos e përdorur pranimin e fajit si një mënyrë efektive dhe e shpejtë për ta përfunduar procedurën penale është politika e butë ndëshkuese, që do të thotë se, pas përfundimit të procedurës së rregullt penale, të akuzuarit zakonisht do ta merrnin ose dënimin e njëjtë penal ose dënimin më të lehtë sesa në rastet kur do të pajtoheshin ta pranonin fajin. Mu kjo është arsyeja pse konsiderojmë se duhet të përgatitet një Udhëzues për gjyqtarët dhe palët në procedurën penale, përmes të cilit sanksioni i propozuar dhe ulja e tij sa i përket veprës konkrete penale do të ishin të qarta në rast se bëhet pranimi i fajit nga i akuzuari. Megjithatë, konsiderojmë se ky Udhëzues nuk duhet të jetë i detyrueshëm, por duhet të jetë vetëm informues dhe duhet të përgatitet në përputhje me kriteret reale, objektivisht të matshme dhe kriteret statistikore dhe të drejta<sup>18</sup>. Me fjalë të tjera, diametralisht i kundërt me Ligjin paraprak për Përcaktimin e Llojit dhe Lartësisë së Sanksionit Penal, i cili, për fat të mirë, është shfuqizuar. Probabiliteti i sanksionit për sa i përket llojit dhe lartësisë mund të arrihet edhe duke e përdorur sistemin AKMIS, në atë mënyrë që prej tij do të gjeneroheshin sanksionet mesatare për veprat e ngjashme penale, por duke e pasur parasysh shkallën e cilësisë në të cilën ndodhet ky

17 Shih: Kanevçev M., Për disa zgjidhje (kontraverze) nga Ligji për Përcaktimin e Llojit dhe Lartësisë së Sanksionit Penal, MRKPK, viti 24, nr. 1, 2017, gjendet në: <http://maclc.mk/Upload/Documents/Metodija%20Kanevchev%202.pdf> ose Tupançeski N., Deanoska Trendafillova A., Një vit nga zbatimi i Ligjit për Përcaktimin e Llojit dhe Lartësisë së Sanksionit Penal - Problemet dhe sfidat, MRKPK, viti 24, nr. 1, 2017, gjendet në: <http://maclc.mk/Upload/Documents/Tupanceski,%20Deanoska.pdf>

18 Sipas mënyrës së përgatitjes së Udhëzimeve Federale për Ndëshkim të SHBA-ve, shih Gruevska Drakulevski A., Misoski B., Analizë krahasuese e mekanizmeve të udhëzimeve për matjen e dënimit: Udhëzime për matjen e dënimeve në SHBA, MRKPK, viti 21, nr. 1, 2014, gjendet në: <http://maclc.mk/Upload/Documents/06.pdf>. Me këtë rast apelojmë që të kihet kujdes të mos përsëritet gabimi që është bërë me Rregulloren për matjen e dënimit, të miratuar nga GjSRMV-ja, e cila ishte gjithashtu një moment interesant në historinë më të re juridike të Maqedonisë së Veriut. Shih: Lazhetiç Buzharovska G., Politika e pabarabartë ndëshkuese dhe ndikimi i saj në marrëveshjen për fajin për sanksionin penal sipas Ligjit për Procedurën Penale, MRKPK, viti 21, nr. 1, 2014, gjendet në: <http://maclc.mk/Upload/Documents/03.pdf>



sistem, konsiderojmë se kjo mënyrë e përcaktimit të sanksioneve mesatare do të ishte e sigurt vetëm pas një reforme të plotë dhe përmirësimit të sistemit AKMIS dhe pas zbatimit të tij adekuat për disa vite me radhë, në mënyrë që të fitohen tregues relevantë statistikorë nga lëndët që janë futur në këtë sistem<sup>19</sup>.

Arsyeja e dytë për të mos e përdorur procedurën për pranimin e fajit nga i pandehuri gjatë procedurës penale mund të gjendet edhe në kohëzgjatjen e procedurës penale dhe në paqartësinë për t'u dënuar pas procedurës së kryer penale për të cilën, kohët e fundit, gjithnjë e më shumë jemi dëshmitarë. Në fakt, për shkak të shtyrjeve të shpeshta në seancave gjyqësore, shpesh edhe për fajin e të akuzuarve dhe avokatëve të tyre mbrojtës<sup>20</sup>, të cilët gjejnë mundësi të procesit për ta vonuar procedurën penale, madje edhe pas skadimit të afateve të vjetërsisë për ndjekje penale, duket se ndonjëherë është me të vërtetë e gabuar të pritet që të akuzuarit të dëshirojnë që procedura penale që zhvillohet kundër tyre të përfundojë vetëm në një seancë dhe në një interval kohor relativisht të shkurtër dhe të shpejtë.

Një argument shtesë për këtë pretendim është edhe fakti se nga 7 pranime të fajit gjatë shqyrtimit kryesor, 5 janë dhënë për vepra të lehta për të cilat zhvillohet procedurë e shkurtuar, ndërsa vetëm 2 pranime të fajit janë bërë për vepra penale për të cilat është paraparë dënim me më shumë se 5 vjet burg dhe për të cilat zhvillohet procedurë e rregullt penale. Kjo do të thotë se të pandehurit nuk janë të gatshëm ta pranojnë menjëherë fajin për veprat më të ndërlikuara dhe më të rënda, por edhe sikur të vendosin ta pranojnë fajin, këtë zakonisht e bëjnë për veprat penale për të cilat zhvillohet procedurë e shkurtuar.

Në këtë drejtim, konsiderojmë se është e nevojshme të rritet efikasiteti i gjykatës në procedurë, dhe kështu të rritet siguria për një epilog të plotfuqishëm të procedurës penale, si bazë për rritjen e numrit të pranimeve të fajit nga ana e të akuzuarve gjatë procedurës penale.

Një argument shtesë në lidhje me rënien e numrit të pranimeve të fajit, ndonjëherë mund të gjendet edhe tek pala e provës së aktakuzës. Në fakt, duke e marrë parasysh kryesisht natyrën komplekse të veprave penale që ishin objekt i vëzhgimit dhe i analizës këtë vit, si dhe faktin që në këto raste shpeshherë bëhet fjalë për të akuzuar me lidhje të forta shoqërore përmes të cilave ndonjëherë gjatë procedurës penale kalkulojnë edhe me mundësinë për të ndikuar në prova të caktuara, kryesisht mbi dëshmitarët, në favor të caktuar të tyre, në raste të proceseve gjyqësore që zgjasin shumë, duket se ata kanë tendencë për ta ndryshuar mendimin e tyre pikërisht për shkak të frikës nga paqartësia e procedurës penale. Thënë të vërtetën, rregullimi aktual i sistemit të procedurës penale, kur këto prova mblidhen vetëm gjatë hetimit, dhe nxirren vetëm gjatë shqyrtimit kryesor, ose kur deklaratat e dëshmitarëve gjatë hetimit vetëm shënohen në procesverbal, e më rrallë edhe incizohen te prokurori publik, me ç'rast më pas kanë përdorim të kufizuar në këtë formë gjatë shqyrtimit kryesor, ka ndikim të madh te dëshmitarët dhe gatishmëria e tyre për të dëshmuar gjatë gjykimeve. Mu për këtë arsye, konsiderojmë se, veçanërisht në këto raste, gjyqtarët duhet ta marrin parasysh zbatimin e dispozitave të LPP-së, në aspekt të koncentrimin të seancave gjyqësore dhe harmonizimit të orareve të të gjitha subjekteve të përfshira në procedurën penale në mënyrë që do të mundësonte koncentrim të seancave gjyqësore, e jo caktimin e tyre me një shpeshësi prej një deri në dy seanca në muaj.

19 Në këtë mënyrë, do të ndiqeshin përvojat e gjykatave në Angli, për më shumë shih: M. McConville, "Plea Bargaining: Ethics and Politics", *Journal of Law and Society*, Vol. 25, no. 4, 1998, fq. 570 dhe të tjerët; ose Sprack John, *A Practical Approach to Criminal Procedure*, Oxford University Press, 10-th Edition 2005, fq. 92.


20 Në këtë drejtim, shih të dhënat e fundit nga Gjykata Themelore Penale mbi vjetërsimin e lëndës së njohur më mirë me emrin "TNT".



## ANALIZË e të dhënave nga vëzhgimi i procedurave gjyqësore në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit në vitin 2019


Nga ana tjetër, duke e analizuar drejtësinë dhe ligjshmërinë e procedurës në rastet e pranimit të fajit, nuk mund të konstatojmë keqpërdorime të mëdha të procesit, për shkak të të cilave ky institut nuk do të zbatohet ose do të kishte një rënie kaq drastike.

Në fakt, nëse merren parasysh të dhënat nga vëzhguesit tanë nga seancat e vëzhguara në të cilat është bërë pranimi i fajit, mund të konkludojmë se në 6 nga 7 raste gjykata ka vepruar në përputhje me dispozitat e LPP-së, në mënyrë adekuate i kanë respektuar drejtat të të akuzuarit me këshillim të qartë për llojin e akuzës me të cilën ngarkohet i akuzuari, si dhe pasojat nga pranimi i fajit, por edhe se ka bërë përpjekje adekuate profesionale për të vlerësuar nëse pranimi i fajit është bërë me vetëdije dhe vullnetarisht (shih grafikun nr.21).



Grafiku nr.21  
(Pranime të fajit)


Sa i përket mbështetjes me fakte të pranimeve të fajit, në 6 raste janë nxjerrë prova në lidhje me dënimin e mëparshëm të të akuzuarit, ndërsa në 3 raste janë nxjerrë prova për gjendjen shëndetësore të të akuzuarit. Konsiderojmë se praktika e vlerësimit të gjendjes shëndetësore të të akuzuarit është veçanërisht për t'u përhëndetur, sidomos në rastet kur gjykata ka dyshime për aftësinë e të akuzuarit për ta pranuar fajin (Grafiku Nr.22).



Grafiku nr.22  
(Provat e nxjerra pas pranimit të fajit)

Për t'u përhëndetur është edhe fakti se në të gjitha rastet në procedurë të rregullt kur është bërë pranimi i fajit, i akuzuari kishte avokat mbrojtës, i cili nuk kundërshtoi se nuk ka pasur kohë të mjaftueshme për përgatitjen e duhur për mbrojtje efikase të të akuzuarit. Megjithatë, për fat të keq, një pranimi i fajit në procedurë të shkurtuar është bërë pa praninë e avokatit mbrojtës, gjë që nuk është në kundërshtim të qartë me dispozitat e LPP-së, por konsiderojmë se në këto raste, e duke i pasur parasysh garantitë më të rëndësishme të procesit që i ka akuzuari gjatë shqyrtimit kryesor, e nga të cilat heq dorë vullnetarisht me pranimin e fajit, gjykata duhet ta paralajmërojë të akuzuarin të kërkojë ndihmë nga avokati mbrojtës (shih Grafikun nr.23).

Pranimi i fajit në procedurë të rregullt dhe të shkurtuar, me dhe pa avokat mbrojtës




Grafiku nr.23

(Pranimi i fajit dhe avokati mbrojtës)

Mu për këtë arsye, konsiderojmë se nevojiten hulumtime të mëtejshme për ta përcaktuar rolin efikas të gjykatës<sup>21</sup> në mbrojtjen e të drejtave të të akuzuarit në rrethana kur pranimi i fajit është bërë pa avokat mbrojtës në procedurë të shkurtuar. Në bazë të kësaj, konsiderojmë se ndoshta mund të jetë e arsyeshme të mendohet për korrigjimin e dispozitave të LPP-së duke futur praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës në kushte kur ka gatishmëri për pranim të fajit gjatë shqyrtimit kryesor edhe në procedurën e shkurtuar, si një garantues tjetër shtesë i të drejtave të të akuzuarit, pavarësisht nga fakti se në këto raste gjykata është ajo që i garanton këto të drejta të të akuzuarit.

72



Grafiku nr.24

(Vendimi i gjykatës)

Gëzon fakti që kemi rritje sa i përket vendimit të gjykatës për elementet dytësore të vendimit për lëndën penale, përveç elementeve kryesore që lidhen me llojin e veprës në kushte kur është bërë pranimi i fajit nga ana e të akuzuarit. Kështu, nga të dhënat e vëzhguesve tanë mund të konstatohet se gjykata ka vendosur edhe për sendet e konfiskuara edhe për shpenzimet gjyqësore, që në fakt është edhe detyrim ligjor në këto raste. Në këtë drejtim, do ta përsërisim përfundimin e vitit të kaluar<sup>22</sup> se me

21 Për këtë qëllim, mund të shfrytëzohen njohuritë nga modeli burimor, të zbuluara nga Alshuler në: Alshuler, Albert W., The Trial Judge's Role in Plea Bargaining, Part I, Columbia Law Review, Vol. 76, No. 7. (Nov., 1976), pp. 1059-1154, si dhe nga autorët vendas: Misoski B., Ilikj Dimoski D., Judges' Role in the Evaluation of the Defendant's Plea within the Sentence Bargaining Procedure, Journal of the Faculty of Security, Skopje, University St. Klement of Ohrid, Bitola, 2016.

22 Shih: Misoski B., Avramovski D., Petrovska N., Analiza e të dhënave nga procedurat e vëzhguara gjyqësore në vitin 2018, Misioni i OSBE në Shkup. viti 2019

rritjen e përqindjes së vendimit të gjykatës, përveç për sanksionin dhe për elementet e tjera, e veçanërisht për dëmin, rritet besimi në gjyqësi, pasi që krijohet përshtypja në opinion se gjykata plotësisht e ka qartësuar ngjarjen penale-juridike në raport me të gjithë personat e interesuar. Në këtë mënyrë, publiku arrin në përfundimin se në rastet kur i akuzuari e ka pranuar fajin, të gjitha karakteristikat dhe garancitë e procedurës penale mbesin të respektuara, e me këtë edhe kjo procedurë perceptohet si e drejtë dhe e pranueshme. Mu për këtë arsye, konsiderojmë se gjyqtarët duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha në këto raste dhe më shpesh të marrin vendim edhe për kompensim të dëmit, e jo t'i këshillojnë palët e dëmtuara që të ngrenë konteste civile (shih grafikonin numër 24).

Nga zbatimi i deritanishëm i pranimit të fajit nga i akuzuari gjatë shqyrtimit kryesor, sipas të dhënave tona nga lëndët e vëzhguara, instituti maqedonas i pranimit të fajit ka zhvilluar disa specifika në krahasim me zgjidhjen origjinale të huazuar dhe të adaptuar nga sistemi i drejtësisë penale të SHBA-ve. Në këtë drejtim, mund të veçojmë disa përfundime interesante, të cilat në praktikë janë problematizuar, në një farë mënyre, nga kërkëpamjet teorike mbi drejtësinë dhe efikasitetin e pranimit të fajit, gjë që, nga ana tjetër, detyrimisht kërkojnë ndryshim ose korrigjim dhe përmirësim, ose koment adekuat për zbatimin e drejtë të dispozitave të LPP-së, me të cilat rregullohet pranimi i fajit.

Aspekti i parë, të cilin ne e konsiderojmë të përshtatshëm për t'u komentuar, është shkalla e bindjes së gjykatës për sa i përket pranimit të fajit. Në fakt, sipas praktikës së vëzhguar, është e qartë përshtypja se gjykata i beson së tepërmi pranimit të fajit nga i akuzuari<sup>23</sup> dhe se, pothuajse aspak, përveç me përjashtim, nuk nxjerr prova në mbështetje të vërtetësisë së pranimit të fajit. Sipas kësaj, është e qartë përshtypja, e cila njëkohësisht është e gabuar, se pranimi i fajit nga i akuzuari është mbretëresha e provave dhe se ka forcë të lartë provuese, me ç'rast bëhet formalizimi i provave. Sipas koncepteve teorike nga e drejta krahasuese, konsiderojmë se është e udhës që t'i përsërisim specifikat konceptuale të pranimit të fajit të bëra gjatë shqyrtimit kryesor sa i përket peshës së tij provuese. Në fakt, sipas sistemit origjinal të së drejtës penale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në kushte kur është bërë pranimi i fajit nga i akuzuari gjatë shqyrtimit kryesor, gjykata duhet të jetë e bindur në një nivel që është midis mbizotërimit të provave dhe bindjes përtej dyshimit të arsyeshëm<sup>24</sup>. . . Ose, në praktikë, kjo do të nënkuptonte se prokurori publik ka prova adekuate në cilësinë e të cilave ai vetë është i bindur përtej dyshimit të arsyeshëm se pas kryerjes së procedurës së rregullt penale duke i prezantuar provat do të jetë në gjendje ta bindë gjykatën se i pandehuri është fajtor përtej dyshimit të arsyeshëm<sup>25</sup>. Me këtë rast, në asnjë rast gjykata federale në SHBA nuk është e kufizuar për ta nxjerrë cilën do qoftë provë nga lista e provave që është në favor të aktakuzës, por ajo që është thelbësore për këtë institut në SHBA, është ajo se gjatë seancës për vlerësimin se pranimi i fajit a është bërë me vetëdije dhe në mënyrë vullnetare, gjykata të kërkojë nga i akuzuari që ai/ajo në tërësi vetë ta pranojë veprën penale për të cilën e pranon fajin dhe të përshkruajë se si është kryer vepra, ose të paktën ashtu siç është përshkruar në aktakuzë. Në këtë mënyrë edhe gjykata në gjykatat federale në SHBA mund të vlerësojë se a bëhet fjalë për pranim të vërtetë dhe të plotë të fajit apo për pranim të pjesshëm ose të rremë të fajit, gjegjësisht a ta pranojë ose jo pranimin e fajit nga i akuzuari.

23 Për peshën e provës së pranimit të fajit, shihni Damaska M., Okrivljenikov iskaz kako dokaz u suvremenom krivičnom procesu, Narodne Novine, Zagreb, 1962, fq. 65.

24 Shih: Hall D.E., Criminal Law and Procedure, 5th Edition, Delmar Cengage Learning, 2009, fq. 394, ose Tapper, C., Cross and Tapper on Evidence, 12th Edition, Oxford University Press, fq. 627 ose të Ingram L.J., Criminal Evidence, 12-ed. Elsevier, 2015; si dhe për shembull: Viano, E., Plea Bargaining in the United States: a Perversion of Justice, Revue Internationale De Droit Penal 2012/1-2 (vol. 83), gjendet në: <https://www.cairn.info/revue-internationale-de-droit-penal-2012-1-page-109.htm#>

25 Shih: Israel J.H., Kamisar, Yale, LaFave W. R., Criminal Procedure and the Constitution, Leading Supreme Court Cases and Introductory Text, 2003 Edition, ThomsonWest ose Bibas S., Incompetent Plea Bargaining and Extrajudicial Reforms, Harvard Law Review, Vol. 126, 150:2012, gjendet në: [https://www.law.upenn.edu/cf/faculty/sbibas/workingpapers/126HarvLRev150\(2012\).pdf](https://www.law.upenn.edu/cf/faculty/sbibas/workingpapers/126HarvLRev150(2012).pdf)

Për dallim nga Rregullat federale të procedurës penale dhe nga praktika e gjykatave federale në SHBA, në vendin tonë, në një farë mënyre, procesi është vendosur mbrapshtë, kështu që pas prezantimit të aktakuzës nga prokuroria, gjykata vetëm përcakton nëse i pandehuri është i vetëdijshëm për atë se çka pranon, dhe nëse pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare, pa kërkuar me këtë rast nga i akuzuari që të dëshmojë dhe të shpjegojë se si dhe pse është kryer vepra penale për të cilën akuzohet, duke dhënë kështu dëshmi që do të paraqiste pranim të plotë të fajit, ngjashëm me zgjidhjen origjinale anglo-saksone. Shikuar në këtë mënyrë, procedura kur kemi pranim të fajit te ne formalizohet në mënyrë të pajustificueshme, ndërsa pranimi i fajit glorifikohet.

Mekanizmi korrigjues në sistemin tonë të drejtësisë penale konsiston në paragrafin 3 të nenit 381 të LPP -së, i cili e rregullon procedurën e pranimit të fajit. Në fakt, në sistemin tonë juridik penal, mekanizmi mbrojtës për gjykatën nga pranimet e pavërteta dhe jo të plota të fajit përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë konsiston në fazën e vlerësimit nga ana e gjykatës nëse pranimi i fajit nga i akuzuari është bërë në mënyrë vullnetare, nëse i akuzuari është i vetëdijshëm për pasojat juridike nga pranimi i fajit, dhe nëse është i vetëdijshëm për pasojat që lidhen me kërkesën pronësore-juridike dhe me shpenzimet e procedurës penale (neni 381 paragrafi 2); dhe bëhet menjëherë pas fjalimeve hyrëse dhe këshillave për të drejtat, në kuptim të neneve 380 dhe 381 paragrafi 1 i LPP-së. Ndërsa, pjesa e dytë realizohet pas vlerësimit të asaj se a është bërë pranimi i fajit me vetëdije dhe në mënyrë vullnetare nga i akuzuari, me ç'rast në kuptim të paragrafit 3 të nenit 381 të LPP-së, gjykata në procedurën e provave do t'i nxjerrë vetëm ato prova që lidhen me vendimin për sanksionin.

Atë që ne e konsiderojmë si jo të drejtë ose, thënë ndryshe, si interpretim tepër kufizues i dispozitave të LPP-së nga gjykatat zbulohet në praktikën e gjykatave në RMV, si mbështetje për vendimin për sanksionin të merret vetëm prova për dënimin e mëparshëm të të akuzuarit, që si provë, është me të vërtetë e rëndësishme për përcaktimin e llojit dhe lartësisë së sanksionit penal, por nuk ka absolutisht asnjë peshë të provës, në kuptim të asaj se pranimi i fajit a është i vërtetë apo jo.

Në lidhje me këtë, konsiderojmë se përmes një interpretimi të këtyllë, pa dyshim të ngushtë, të dispozitës së paragrafit 3 të nenit, në praktikë, në fakt, pranimi i fajit fiton në mënyrë të pajustificueshme peshë më të madhe se sa provat e tjera. Mu për këtë arsye, konsiderojmë se në kuptim të postulateve teorike moderne për peshën e barabartë të provës dhe për forcën e pranimit të fajit si provë, duhet të bëhen korrigjime të caktuara të ligjit të procesit, edhe atë në dy drejtime. I pari, dhe në të njëjtën kohë edhe më i thjeshti, është fshirja e fjalëve nga pjesa e paragrafit 3 të nenit 381 që i referohen llojeve të provave, gjegjësisht fjalët "prova që kanë të bëjnë me vendimin për sanksionin". Kjo aq më tepër kur dihet se në legjisllacionin tonë nuk ka ndarje në prova për ta mbështetur vendimin për sanksionin dhe prova për ta mbështetur vendimin për fajin.

Në këtë mënyrë gjykata mund të nxjerrë sa të ketë nevojë prova, si në aspekt të sasisë ashtu edhe në aspekt të cilësisë, për t'u bindur për vërtetësinë e pranimit të fajit.

Ndryshimi i dytë i LPP duhet të përfshijë, në përputhje me rekomandimet e vitit të kaluar,<sup>26</sup> futjen e një seance të veçantë të provës për përcaktimin e sanksionit, në përputhje me modelin origjinal në SHBA<sup>27</sup>, me ç'rast palët do të ishin të detyruara të paraqesin se kanë prova me shkallë mbizotërimi të bindjes se pranimi i fajit është i vërtetë apo jo, dhe pastaj, pas kundërshtimit eventual të njëres prej

26 Shih: Misoski B., Avramovski D., Petrovska N., Analiza e të dhënave nga procedurat e vëzhguara gjyqësore në vitin 2018, Misioni i OSBE në Shkup, viti 2019

27 Shih: Haddad, James B., et al, Criminal Procedure, Cases and Comments, 5-th ed. Foundation Press, New York, 1998.

palëve, provat e kontestuara të mund edhe të nxirren edhe të vlerësohen në një procedurë kundërshtuese. Përgjigja në lidhje me atë se kjo mundësi e propozuar a do të kishte ndikim dhe në çfarë mase do të ndikonte në praktikë, meriton analiza dhe hulumtime të mëtejshme, të cilat padyshim që duhet të kryhen dhe rezultatet e të cilave, shpresojmë se do të kontribuojnë në rritjen e zbatimit të këtij instituti në të drejtën tonë penale-të procesit.


## SHQYRTIMI KRYESOR - PROCEDURA E PROVAVE

Me kalimin nga sistemi akuzator në sistemin kundërshtues në Ligjin për Procedurën Penale, ndryshoi edhe vetë dinamika e zhvillimit të procedurave, rregullat sipas të cilave zhvillohen ato, por u bë edhe avancimi i të drejtave të palëve në procedurë, veçanërisht garancitë e procesit për personat e akuzuar. Në mënyrë analogjike me këtë, faza kryesore në procedurë - "provimi i fakteve", mori një dimension krejtësisht tjetër për dallim nga më parë. Mënyra e nxjerrjes dhe paraqitjes së provave në të cilat bazohet aktakuza dhe mbrojtja, mënyra e marrjes në pyetje të dëshmitarëve në procedurë, roli i gjykatës në zhvillimin e procedurës, përdorimi i burimeve shtesë të ekspertëve si për prokurorinë ashtu edhe për mbrojtjen, marrja në pyetje e të akuzuarit, nëse bëhet kjo, gjegjësisht nëse i akuzuari vetë i nënshtrohet këtij procesi, etj., janë vetëm disa nga ndryshimet kryesore të përcaktuara në LPP-në aktuale, zbatimi i të cilave, përkundër zbatimit shumë vjeçar, nuk është i plotë dhe i saktë.

Faza e nxjerrjes së provave është thelbësore në një procedurë. Kjo për faktin se përmes mënyrës dhe rregullave për nxjerrjen e provave, në fund përcaktohet pesha e tyre e provës dhe mundësia që ato të përgënjeshtrohen, si dhe aftësia e përfaqësuesit të prokurorisë për t'i vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm meritat e një aktakuze, dhe me këtë ta dëshmojë edhe kryerjen e veprës.

Pasi që barra e provës qëndron në anën e prokurorisë, ligji i jep përparësi në rendin e nxjerrjes së provave anës së përfaqësuesit të aktakuzës. Kështu, së pari të gjitha provat e propozuara në listën e provave, të cilat janë paraqitur me aktakuzën, nxirren nga prokuroria, e pastaj nxirren provat e mbrojtjes. Për t'i përgënjeshtrohet provat e nxjerra, ligji parashikon mundësinë që të nxirren edhe prova të tjera shtesë me propozimin e të dyja palëve, por vetëm kur bëhet fjalë për prova të cilat palët nuk kanë pasur mundësi t'i propozojnë në listën e provave, apo për të cilat nuk kanë pasur njohuri deri atëherë.


Siç mund të shihet edhe në paraqitjen grafike nr. 25, provat, në parim, nxirren në përputhje me renditjen e përcaktuar me ligj. Mirëpo, janë regjistruar edhe përjashtime në përqindje minimale prej 2%, kur nuk është respektuar kjo rregull, kur, me qëllim që "procedura të jetë më ekonomike" është ndryshuar renditja, me qëllim që të shfrytëzohet mundësia e pranisë së ndonjërit prej dëshmitarëve të propozuar që ai të merret në pyetje kur tashmë gjendet në ndërtesën e gjykatës. Ndodh që gjykata ta bëjë këtë përjashtim në përputhje me nenin 385 paragrafi 1 të LPP-së, kur lejohet që ajo të bëjë vlerësim për zbatimin e kësaj mundësie sa herë që kjo është në interes të aspektit ekonomik të procedurës, gjegjësisht për ta "përsheptuar" atë.



Grafiku nr.25  
A ishte renditja e nxjerrjes së provave sipas renditjes së paraparë me ligj?

Ajo që është veçanërisht e rëndësishme për prezantimin e drejtë dhe për vlerën bindëse të teorive të rastit të të dyja palëve (prokurorisë dhe mbrojtjes) është mundësia që secila nga palët ta krijojë në mënyrë përkatëse orarin dhe planin e nxjerrjes së provave, por gjithashtu edhe mundësia që ato të prezantohen nga palët të cilat i kanë propozuar ato.

Nga të dhënat e përpunuara që janë mbledhur nga terreni, analiza tregon se në vetëm 3% të rasteve ka pasur devijime nga lista e provave të ndonjërës nga palët. Statistikisht, duke i pasur parasysh të dhënat nga vitet e kaluara, kjo shifër paraqet një lloj konstante, gjegjësisht nuk ka as përmirësim e as kthim prapa.




Grafiku nr.26

(A ishte nxjerrja e provave në përputhje me listën e provave të palës)

Duke pasur parasysh se barra e provës qëndron te prokurori publik, nëse merret në konsideratë parimi i natyrës akuzatore të procedurës, ligji përcakton se provat do të nxirren drejtpërdrejt në shqyrtimin kryesor, me atë që jepet mundësia që pikërisht përmes nxjerrjes së drejtpërdrejtë të provave, t'i nënshtrohen marrjes së kryqëzuar në pyetje nga pala e kundërt. Ideja e nxjerrjes së drejtpërdrejtë të provave qëndron në kontekstin se dëshmitari duhet të merret në pyetje personalisht gjatë shqyrtimit kryesor, e jo që marrja e tij në pyetje të zëvendësohet me leximin e deklaratës nga procesverbali, të cilën dëshmitari e ka dhënë më parë. Megjithatë, ligji le mundësinë e përjashtimit nga ky lloj i nxjerrjes së provave (neni 388 paragrafi 5 i LPP-së) duke mundësuar paraqitjen e disa prej dëshmive të dhëna më parë, kuptohet që janë regjistruar në mënyrë adekuate nga ana e organeve kompetente. Kështu, në mënyrë që dëshmitë e disa personave të mund të përdoren më vonë për prezantim gjatë marrjes në pyetje në formë të kryqëzuar ose për përgënjeshttrimin e pretendimeve të bëra më parë, me qëllim që të bëhet vlerësimi i vërtetësisë së dëshmive të dhëna në shqyrtimin kryesor, palët në procedurë kanë mundësinë ta praktikojnë këtë përjashtim nga rregulli për nxjerrjen e drejtpërdrejtë të provave në përputhje me ligjin.

Zbatimi i këtij përjashtimi u ndoq gjatë procedurave që ishin subjekt i monitorimit gjatë vitit të kaluar, pas të cilit i fituam të dhënat e paraqitura në paraqitjen grafike nr. 27 më poshtë. Në fakt, në përqindjen më të madhe nuk është devijuar nga rregulli për nxjerrjen e drejtpërdrejtë të provave (78%), ndërsa kur ka ndodhur ky përjashtim, kjo është bërë për shkak të nevojës për t'i kujtuar rrethanat të cilat dëshmitari nuk i ka mbajtur mend (11%), si dhe për shkak të mospërputhjes së dëshmive të dhëna, po ashtu, në përqindje relativisht të vogël (11%).




Grafiku nr. 27

(Gjatë marrjes në pyetje a u përdorën deklaratat/dëshmi që janë dhënë në procedurën paraprake)

Roli pasiv i gjykatës, i cili parashikohet me Ligjin aktual për Procedurën Penale, nënkupton monitorimin e procedurës, si dhe kontrollin mbi mënyrën dhe rendin e marrjes në pyetje të dëshmitarëve


## ANALIZË e të dhënave nga vëzhgimi i procedurave gjyqësore në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit në vitin 2019

dhe të ekspertëve, por dhe nxjerrjen e provave, duke mbajtur llogari për efikasitetin dhe aspektin ekonomik të procedurës. Megjithatë, në vitet e kaluara kemi vërejtur një tranzicion të vështirë në rolin e gjykatës - nga një kontrollues i plotë i procedurës, deri te një vëzhgues relativisht pasiv i saj, në këtë lloj të procedurave tematike që janë ndjekur, procedurat në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit, vërejmë një veprim më të përshtatshëm nga ana e gjykatës. Konkretisht, nëse i shikojmë statistikat e viteve të kaluara nga vëzhgimi i procedurave kundër personave të rritur, do të shohim se roli "i ri" i gjykatës (që ajo të jetë pasive) nuk është zbatuar siç duhet (Grafiku nr.28). Në një përqindje të madhe të procedurave, gjykata ende e merr rolin aktiv të kontrollit mbi marrjen në pyetje të dëshmitarëve. Mirëpo, kur bëhet fjalë për lëndë nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit, vërejmë një përmirësim minimal, por megjithatë një përmirësim, gjegjësisht një rezultat më të mirë në lidhje me këtë çështje. Kështu, nëse gjatë vitit të kaluar kemi identifikuar një situatë të zbatimit të kësaj mundësie nga gjykata, e cila në masë të madhe është e kufizuar me ligj, do të shohim se në lëndët me maturi penale për vitin 2018, shkalla e përfaqësimit të marrjes në pyetje shtesë nga gjykata për t'i sqaruar përgjigjet është rreth 50 përqind, për dallim nga përqindja e lëndëve nga fusha e krimit të organizuar, ku kjo përqindje është shumë pak më e ulët (Grafiku nr.29). Mirëpo, kemi identifikuar një përqindje më të lartë të rasteve kur marrja në pyetje ka kaluar në marrje të veçantë në pyetje (shih Grafikon nr. 29), për dallim nga rastet e lëndëve me maturi penale të vitit të kaluar, me ç'rast përqindja prej 4% në këto raste është dy herë më e ulët se sa në rastet e krimit të organizuar në vitin 2019.



Grafiku nr.28


(A e ushtron gjykata të drejtën e saj sipas nenit 383 paragrafi 5 që edhe vetë t'i parashtrojë pyetje dëshmitarit/ekspertit)



Grafiku nr.29


Pas një analize të hollësishme të kësaj situatë veçmas për çdo qytet ku janë monitoruar gjykimet, mund të shihet se kjo praktikë e shfrytëzimit të mundësisë që gjykata të përfshihet në një kapacitet të caktuar në procesin e marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe kalimin në atë që sipas LPP-së është paraparë si mundësi për gjykatën, do të shohim se statistikisht Gjykata Themelore Penale - Shkup është në një "avantazh negativ" për dallim nga gjykatat e tjera (Grafiku nr.30), gjë që del si përfundim gjatë qasjes sasiore për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave nga lëndët, që në masë të madhe dhe dominuese janë nga Gjykata Themelore Penale në Shkup.





Grafiku nr.30

Një risi interesante që është regjistruar nga vëzhguesit tanë vitin e kaluar është fakti se zbatimi i kundërshtimeve ka marrë një dimension pak më ndryshe se zakonisht. Në fakt, ka pasur raste kur prokuroria publike ose mbrojtja kanë reaguar, gjegjësisht kanë kundërshtuar ndaj pyetjeve të parashtruara nga gjykata për dëshmitarët ose ekspertët, të cilët kanë qenë të thirrur në shqyrtimin kryesor (Grafiku nr. 31).



Grafiku nr. 31

(A kundërshtuan palët sa i përket mënyrës në të cilën parashtrihen pyetjet gjatë marrjes në pyetje?)


Mirëpo, pavarësisht nga ajo se a është kundërshtuar nga njëra ose pala tjetër për pyetjet e palës kundërshtare apo për pyetjet e parashtruara nga gjykata, është regjistruar se gjykata, në një përqindje të madhe prej 15%, nuk i kishte shënuar të gjitha kundërshtimet që iu drejtuan asaj në procesverbalin që përpilohet dhe mbahet nga gjykata.

Ajo që është interesante nga ana tjetër, është mënyra se si gjykata reagon, gjegjësisht kujdeset për lejueshmërinë e pyetjeve. Ligji përcakton se kryetari i këshillit ose gjyqtari individual, pa pasur ndonjë kundërshtim nga ndonjëra prej palëve, kanë mundësinë të reagojnë, gjegjësisht ta pengojnë parashtrimin e ndonjë pyetjeje që nuk është e rëndësishme ose që nuk është e lejuar. Megjithatë, ato **detyrimisht** janë të lidhura me kundërshtimin e palëve kur duhet të refuzohet pyetja e parashtruar gjatë marrjes së drejt-




## ANALIZË e të dhënave nga vëzhgimi i procedurave gjyqësore në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit në vitin 2019

përdrejtë dhe të kryqëzuar në pyetje<sup>28</sup>. Në të dhënat që i kemi në dispozicion, është regjistruar se gjykata reagon më pak ndaj pyetjeve të parashtruara në çdo rast kur nuk ka kundërshtime nga ndonjëra prej palëve, por edhe atëherë kur e bën këtë pa pasur kundërshtim, gjykata reagon në përqindje më të madhe ndaj pyetjeve të parashtruara nga mbrojtja (i akuzuari dhe avokati mbrojtës) se sa në pyetjet e parashtruara nga ana e prokurorit publik (paraqitje krahasuese në grafikët nr. 32 dhe 33).




Grafiku nr.32



Grafiku nr.33

Gjykata u kujdes për lejueshmërinë e pyetjeve dhe marrjen e drejtë në pyetje: PAS kundërshtimit të palës kundërshtare / PA kundërshtimin e palës kundërshtare

Kur bëhet fjalë për mënyrën e nxjerrjes së provave në procedurë, megjithëse ligji parashikon që pala që i propozon provat t'i nxjerrë ato në bazë të rendit sipas të cilit ka vendosur ta bëjë këtë, në mënyrë që të dëshmojë teorinë e saj të rastit dhe ta mbështesë strategjinë e saj për zhvillimin e rastit, shumë shpesh provat nuk janë prezantuar, por ato vetëm janë lexuar, edhe atë vetëm titulli, që tregon se për çfarë lloj prove bëhet fjalë. Prezantimi grafik nr. 34 i referohet mu kësaj praktike të gjykatës, gjegjësisht të palëve në procedurë. Kështu, në vend që në emër të transparencës dhe nxjerrjes së drejtpërdrejtë të provave duke e paraqitur shkurtimisht përmbajtjen e tyre, në mënyrë që të dyja palët, e po ashtu edhe publiku në procedurë, të njihen me ndonjë provë konkrete, është vënë re se, në pjesën dominuese të lëndëve, gjyqtari është ai që e lexon titullin e provës, kështu që nuk bëhet fjalë për nxjerrjen e provave nga palët. E kur gjykata nuk e bën këtë, atëherë edhe pala, në mënyrë identike sikurse edhe gjykata, e lexon vetëm titullin e provës. Në një pjesë shumë të vogël të procedurave, vetë palët i nxjerrin provat duke e informuar gjykatën, palën kundërshtare dhe publikun me përmbajtjen e tyre. Kjo është praktika që duhet të avancohet dhe të përmirësohet, në mënyrë që të praktikohet parimi i nxjerrjes së drejtpërdrejtë të provave në procedurë publike. Kjo për faktin se pavarësisht nga ajo se ligji parashikon barazinë e armëve dhe procedurë publike për palët, nëse nuk zbatohen këto parime gjatë të gjitha fazave të procedurës, duke përfshirë edhe këtë - pjesën me nxjerrjen e provave, do të mund të konstatojmë se kjo është po aq e rrezikshme sa dhe gjykimi i mbyllur, në të cilin nxjerrja e provave, si edhe vetë procedura, zhvillohet pas "dyerve të mbyllura".




Grafiku nr.34

(Si u nxorën provat me shkrim dhe ato materiale)


Ligji për Procedurën Penale e rregullon mënyrën e incizimit të shqyrtimit kryesor në nenin 374. Është paraparë që rrjedha e shqyrtimit kryesor të incizohet me zë ose në mënyrë audio-vizuale, ndërsa në fillim të shqyrtimit, kryetari i këshillit i njofton palët e pranishme dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë për atë se shqyrtimi incizohet, dhe se incizimi paraqet shënim vizual me zë nga shqyrtimi i mbajtur. Në lidhje me këtë çështje, për çdo vit konstatohet situatë identike, pavarësisht nga ajo se a bëhet fjalë për lëndë penale kundër personave të rritur ose për lëndë (këtë vit) nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit. E ajo është se gjykata nuk bën përpjekje të mjaftueshme për ta korrigjuar praktikën e saj të diktimit të asaj që është prezantuar në shqyrtimin kryesor në procesverbal, e aq më pak shqyrtimet i incizon në mënyrë vizuale ose me zë. Gjatë vitit të kaluar, pavarësisht se nuk bëhet fjalë për fushën e njëjtë tematike të monitorimit të procedurave, është vërejtur se ky është një vit në të cilin, për dallim nga vitet e mëparshme, ka pasur numër më të madh të shqyrtimeve që janë incizuar në mënyrë vizuale-me zë. Njëra nga gjendjet e konstatuara në vitin 2018, për të cilën u dha rekomandim, ishte pikërisht nevoja për incizimin e shqyrtimeve, sepse, gjatë asaj periudhe, asnjë shqyrtim i vëzhguar nuk ishte incizuar. Mirëpo, këtë vit, siç mund të shihet nga paraqitja grafike nr. 35, është regjistruar një përqindje (relativisht) e lartë e shqyrtimeve (19%) që janë incizuar në mënyrë vizuale-me zë, por megjithatë, përqindja e lartë e mbajtjes së procesverbaleve që diktohen nga ana e gjykatave, në vend që të futet përmbajtja drejtpërdrejt nga palët është qartazi dominuese. Kjo çon më tej në një numër të madh, shqetësues, të shqyrtimeve që incizohen përmes diktimit nga ana e kryetarit të këshillit në procesverbal.

## ANALIZË e të dhënave nga vëzhgimi i procedurave gjyqësore në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit në vitin 2019



Grafiku nr.35

(Si regjistroheshin rrjedha dhe nxjerrja e provave në shqyrtimin kryesor)



Grafiku nr.36

Kur bëhet fjalë për qasjen krahasuese për analizë mes Gjykatës Themelore Penale - Shkup me gjykatat e tjera në vend, në lidhje me trajtimin e kësaj çështjeje, është e qartë se vetëm në këtë gjykatë (Grafiku nr.36) ka mundësi për incizim audio-vizual të shqyrtimeve, që në një farë mase edhe praktikohet, por padyshim se është e nevojshme të sigurohen kushte edhe për gjykatat e tjera me pajisje adekuate teknike për zbatimin e kësaj mënyre të incizimit të shqyrtimeve. Sidoqoftë, edhe në gjykatat e tjera, qasja mbizotëruese për evidentimin e shqyrtimeve është të mbajtja e procesverbalit për to, i cili diktohet nga ana e gjykatës.

## E DREJTA PËR GJYKIM TË DREJTË

E drejta për gjykim të drejtë të parashikuar dhe mbrojtur nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në mënyrë identike, ajo është e mbrojtur edhe me legjislacionin e vendit, si në aktin më të lartë të vendit - në Kushtetutë, ashtu edhe në ligjet e procesit.

Ligji për Procedurën Penale parashikon dispozita që lidhen ngushtë dhe zbatohen për mbrojtjen e standardeve të gjykimit korrekt dhe të drejtë. Konkretisht, neni 5 i këtij ligji parashikon dhe garanton të drejtën për gjykim publik dhe të drejtë para një gjykate të pavarur dhe të paanshme, në një procedurë kundërshtuese, në të cilën personi i akuzuar mund t'i kontestojë faktet dhe provat, gjegjësisht aktakuzën kundër tij, por dhe të marrë pjesë në mënyrë aktive në procesin e ndërtimit të mbrojtjes së tij duke nxjerrë dhe propozuar prova. Neni 6 i LPP-së e shtjellon konceptin kohor të kohëzgjatjes së procedurës, kështu që parashikon nxjerrjen e personit ndaj të cilit zhvillohet procedura përpara gjykatës brenda një kohe të arsyeshme, si dhe gjykimin e tij pa shtyrje të paarsyeshme të procedurës.

## BARAZIA E ARMËVE

Parimi i barazisë së armëve nënkupton se rrethanat, përkatësisht kushtet gjatë gjykimit dhe marrjes së vendimit duhet të jenë të barabarta për të gjithë palët në procedurë. Ekuilibri i drejtë ndërmjet palëve në procedurë nënkupton se secila prej tyre duhet të ketë mundësinë ta paraqesë rastin e saj dhe


gjatë kësaj asnjëra palë nuk duhet të jetë në pozicion të privilegjuar ndaj palës tjetër. Ky parim është një segment i trashëguar i parimit për gjykimin korrekt dhe është i lidhur me parimin e barazisë para gjykatave.

Me fjalë të tjera, përmes parimit të barazisë së armëve, gjykata e garanton të drejtën e të dyja palëve që të kenë kohë, mundësi dhe mjete të barabarta dhe të mjaftueshme për ta prezantuar rastin e tyre para një arbitri të pavarur. Përveç kësaj, sipas parimit të barazisë së armëve, të akuzuarit duhet t'i sigurohet kohë dhe mjete të mjaftueshme që të mund ta prezantojë teorinë e tij të rastit, gjegjësisht t'i garantohen mjete dhe kohë e mjaftueshme për përgatitjen e tyre që të jetë në gjendje ta kundërshtojë në mënyrë efikase teorinë e rastit të prokurorit.

Komiteti për të Drejtat e Njeriut e ka përshkruar këtë parim si një domosdoshmëri që të gjitha palët t'i gëzojnë të njëjtat të drejta të procesit në procedurë, përveç nëse, kuptohet, dallimet nuk janë parashikuar me ligj dhe nuk janë të arsyeshme, duke mos lejuar me këtë rast disavantazh të konsiderueshëm për njërin nga palët. Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut, në kontekstin e procedurave penale, e përcakton këtë parim si barazi të procesit të të akuzuarit me prokurorin.


Për ta përcaktuar gjendjen për respektimin e këtij parimi kyç të procedurës penale, në kuadër të hulumtimit të kryer në terren, në pyetësorin që e plotësonin vëzhguesit ishin paraparë edhe pyetje që, vetvetiu, janë tregues për zbatueshmërinë e këtij parimi. Kështu, si çështje kyçe, rezultatet e të cilave tregojnë se ka nevojë për përmirësim, do ta theksonim mundësinë për propozimin e provave nga të dyja palët e interesuara në procedurë, si dhe trajtimin e tyre nga gjykata në lidhje me kundërshtimet.

Nga të dhënat e mbledhura në lidhje me atë se a i ka pasur mbrojtja të njëjtat mundësi për të propozuar prova, vërejmë një gjendje identike me të dhënat e vitit të kaluar që kishin të bëjnë me lëndët me maturi penale<sup>29</sup>. Është regjistruar një situatë e cila prej vitesh nuk shënon as rritje as rënie, që në një farë mase paraqet shqetësim, duke pasur parasysh rëndësinë e këtij parimi dhe mungesën e vullnetit për ta përmirësuar atë nga ata që punojnë në praktikë.



Grafiku nr.37

A i kishte mbrojtja mundësitë e njëjta sikurse edhe prokuroria për të propozuar prova?



Grafiku nr.38

A u trajtuan në mënyrë të barabartë mbrojtja dhe prokurori nga gjyqtari në lidhje me kundërshtimet

29 Analiza e të dhënave nga procedurat e vëzhguara gjyqësore në vitin 2018, Docent Dr. Boban Misoski, Darko Avramovski, Natali Petrovska

## ANALIZË e të dhënave nga vëzhgimi i procedurave gjyqësore në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit në vitin 2019


Kur bëhet fjalë për trajtimin e barabartë të palëve në lidhje me kundërshtimet, vërejmë praktikë identike me vitet e kaluara. Ka një përqindje minimale, por megjithatë e rëndësishme prej 4% që i referohet trajtimit të pabarabartë (Grafiku nr.38). Kjo ndërlihet edhe me gjendjen e konstatuar më lartë, në të cilën gjykatat i trajtojnë palët relativisht në mënyrë të pabarabartë në aspektin e kundërshtimeve, kur ato paraqiten në procedurën e provave. Konkretisht, bëhet fjalë për situatën kur, edhe pse në mungesë të kundërshtimeve, gjykata reagon më shumë në pyetjet e parashtruara nga mbrojtja sesa në ato të prokurorisë.

Në përgjithësi, mund të konstatohet se është përmirësuar përshtypja për trajtimin e barabartë të palëve në procedurë, me faktin se është vërejtur vetëm një përqindje minimale prej 1% e gjykimeve të monitoruara, në të cilat është vënë re anshmëri e gjyqtarit në procedurë. Sa i përket çështjes së komunikimit *ex-parte* midis gjykatës dhe prokurorisë, megjithëse në një përqindje të vogël, ajo ende vazhdon.

## E DREJTA PËR GJYKIM PUBLIK

E drejta për gjykim publik bazohet në idenë e hapjes dhe transparencës së punës së organeve gjyqësore dhe është një lloj mbikëqyrje mbrojtëse e interesave të qytetarëve dhe e shoqërisë në përgjithësi. Kjo e drejtë mundëson që publiku të jetë i pranishëm gjatë procedurave gjyqësore dhe paraqet parim nga i cili vëzhguesit gjyqësorë e nxjerrin legjitimitetin e tyre për realizimin e rolit të tyre - vëzhgimin e procedurave gjyqësore. Mbatja e shqyrtimeve publike në gjykata e rrit shkallën e transparencës, siguron integritet në zhvillimin e procedurave gjyqësore, por gjithashtu siguron edhe mbrojtje kundër keqpërdorimit eventual të procedurave. Përjashtimi nga kjo rregull ka të bëjë me përjashtimin e publikut nga procesi i gjykimit në situata të jashtëzakonshme kur bëhet fjalë për moralin, rendin publik, sigurinë kombëtare dhe interesin për ta mbrojtur privatësinë e secilës nga palët në procedurë. Megjithatë, ligji parashikon mundësi në përputhje me nenin 355 paragrafi 2, në procedurat kur është i përjashtuar publiku të mundësohet prania e ekspertëve. Duke pasur parasysh faktin se koalicioni “Të gjithë për gjykim të drejtë” është i njohur nga gjykatat e vendit si e vetmja organizatë vendase që bën monitorim të procedurave gjyqësore për më shumë se një dekadë, përfaqësuesve të saj shpesh u lejohet t'i ndjekin procedurat gjyqësore edhe në situatat kur përjashtohet publiku i zakonshëm. Përmes prizmit të disa prej këtyre treguesve, në vazhdimin e tekstit të kësaj analize, do të prezantohet përshtypja e vëzhguesve në lidhje me parimin e transparencës në procedurat e vëzhguara.

Nga numri i përgjithshëm i shqyrtimeve të monitoruara në vitin 2019, vetëm 1.5% e nuk ishin publike. Duke pasur parasysh faktin se bëhet fjalë për lëndë të një fushë specifike, në të cilat shumë shpesh kemi të bëjmë me siguri të lartë, informacione të klasifikuara dhe mbrojtje të rrethanave nga jeta personale/private e të akuzuarve, të cilët në këto procedura, më shpesh, janë bartës aktualë ose të mëparshëm të funksioneve të caktuara shtetërore, gjykata ka praktikë që ta përjashtojë publikun kur kjo është e nevojshme. Mirëpo, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë, për dallim nga procedurat me maturi penale që ishin objekt i monitorimit gjatë 4-5 viteve të kaluara, dhe në të cilat është regjistruar një shkallë më e lartë e publikut të përjashtuar (~ 2%), në këto procedura kjo përqindje është më e ulët ( Grafiku nr.39). Në 25% të lëndëve në të




Графикон бр.39

cilat publiku ishte i përjashtuar, përfaqësuesit e Koalicionit u lejuan të marrin pjesë në seanca dhe t'i ndjekin ato në cilësinë e ekspertëve.


Sa i përket frikësimit nga ana e gjykatave ndaj përfaqësuesve të publikut, janë regjistruar dy raste të izoluar në Gjykatën Themelore në Prilep dhe në Gjykatën Themelore Penale në Shkup.

Kur bëhet fjalë për publikimin e kohës dhe sallës së gjyqit në të cilën do të mbahen gjykimet, si një element i rëndësishëm i parimit të transparencës së gjykimeve, konsiderojmë se jo vetëm që nuk ka përmirësime në krahasim me vitin e kaluar, por përkundrazi, gjendja përkeqësohet. Në fakt, publikimi i këtyre informatave është shumë i rëndësishëm për rritjen e besimit të publikut në gjyqësi, si dhe për përshtypjen e përgjithshme të funksionimit të gjyqësisë. Analizat e deritanishme tregojnë se ka një trend të rritjes së funksionimit jo transparent të gjykatave në këtë drejtim, por të dhënat nga ky vit e arrijnë "kulmin" më të lartë deri më tani. Në fakt, nëse të dhënat nga vitit 2017 tregojnë se ka pasur 21% të rasteve kur gjykata nuk e ka publikuar kohën dhe vendin e mbajtjes së gjykimet, në vitin 2018 këto të dhëna u rritën në 36%, ndërsa në vitin 2019, nga procedurat e monitoruara në rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit del se në 52% të rasteve, koha dhe vendi i gjykimet nuk ishin publikuar në tabelën jashtë sallës së gjyqit (Grafiku nr.40).



Grafiku nr.40

(A u publikuan vendi dhe koha e gjykimet në tabelën jashtë sallës së gjyqit)




Grafiku nr.41

Kur këto të dhëna shqyrtohen sipas qyteteve, gjegjësisht kur bëhet një paralele midis Gjykatës Themelore Penale - Shkup dhe gjykatave të tjera që ishin subjekt i monitorimit, do të shihet se gjykatat e tjera në vend i kushtojnë më shumë vëmendje publikimit të informacioneve për seancat në tabelat para gjykatave, sesa GjThPSh, sepse në 42 nga gjithsejt numri i të rasteve të vëzhguara anembanë Republikës së Maqedonisë së Veriut, të dhënat janë publikuar (Grafiku nr.41).

Duke i ndjekur statistikat e viteve të kaluara, këtë vit kemi aplikuar një qasje më të thelluar në lidhje me rrethanat kur publiku ishte i përjashtuar nga gjykimet. Kështu, këtë vit kemi analizuar se nëse gjykata ka vendosur ta përjashtojë publikun, e duke marrë parasysh dispozitat e LPP-së që parashohin miratim të detyrueshëm të vendimit për përjashtimin e publikut, a ka marrë ajo një vendim të tillë. Nga të dhënat e përpunuara u konstatua se në 50% të rasteve kur ishte përjashtuar publiku (Grafiku nr.42), gjykata nuk mori vendim për këtë, ndërsa kur u miratua, e përfaqësuesit e Koalicionit ishin të pranishëm në cilësinë e ekspertëve, gjykata fare nuk i ka shpjeguar arsyet për përjashtimin e publikut.


**ANALIZË** e të dhënave nga vëzhgimi i procedurave gjyqësore në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit në vitin 2019



■ PO ■ JO

Grafiku nr.42


A është marrë vendim për përjashtim të publikut



■ Ruajtja e fshehtësisë shtetërore, ushtarake, zyrtare ose afariste  
■ Mbrojtja e interesave të personit të mitur

Grafiku nr.43

Arsyet e përjashtimit të publikut



■ PO ■ JO

Grafiku nr.44

Prania e ekspertëve në përputhje me nenin 355


Arsyeja më e shpeshtë për përjashtimin e publikut në procedura, në 75% të lëndëve të monitoruara ishte "Ruajtja e fshehtësisë shtetërore, ushtarake, zyrtare ose afariste", si dhe "Mbrojtja e interesave të personit të mitur" në 25% të rasteve (Grafiku nr.43). Çështja e lejimit të pranisë së ekspertëve, e cila u diskutua edhe më lartë, është regjistruar në 25% të rasteve (Grafiku nr.44).

## PREZUMIMI I PAFAJËSISË

Prezumimi i pafajësisë është një parim themelor në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe zbatimi i tij praktik nënkupton se: gjykata nuk duhet ta paracaktojë rezultatin e procedurës; prokuroria duhet ta dëshmojë fajin përtej dyshimit të arsyeshëm; mënyra se si është trajtuar i akuzuari nuk duhet të jetë tregues se ai është fajtor; media duhet të jenë të kujdesshme në raportimin e tyre që të mos e dëmtojnë "prezumimi i pafajësisë", e po ashtu edhe autoritetet shtetërore duhet të përmbahen nga dhënia e deklaratave që do ta kishin atë efekt. Çdo person ka të drejtë të trajtohet si i pafajshëm, që nga momenti kur e fiton cilësinë e të dyshuarit, më tej kur ngrihet aktakuza, e deri në shqiptimin e aktgjykimit penal. Ky është parim i detyrueshëm për të gjitha fazat e procedurës. Në përputhje me këtë, Gjykata Evropiane në lëndët *Matijašević kundër Serbisë dhe Garycki kundër Polonisë*<sup>30</sup> thekson se megjithëse është vërtetuar se aplikuesi është fajtor, kjo nuk e liron atë nga e drejta themelore e prezumimit të pafajësisë, derisa të shpallet fajtor sipas ligjit.

30 *Matijašević v Serbia* [2006] ECHR 1161, para 49; *Garycki v Poland* [2007] ECHR 112, para 72.

Nga ajo që u tha më lartë vijon se gjykata në asnjë fazë të procedurës, nuk duhet të ketë mendim të krijuar që më parë për të akuzuarin dhe për fajin e tij të mundshëm në procedurë. Përkundrazi, madje as edhe opsioni për mbrojtje me heshtje nga ana e të akuzuarit, për gjykatën nuk duhet të jetë tregues i fajit. Gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave për këtë çështje, hasëm në të dhënat e mëposhtme: në 93% të rasteve, nuk është dukur se këshilli gjyqësor kishte formuar paraprakisht mendim që mund të ndikonte në marrjen e vendimit (Grafiku nr.45).



Grafiku nr.45


(A dukej se gjyqtari ose anëtarët e këshillit gjyqësor kishin formuar paraprakisht mendim që mund të ndikonte në marrjen e vendimit?)

## E DREJTA E MBROJTJES

Të drejtat e personave të akuzuar janë pjesë e parimit për gjykim korrekt dhe të drejtë. Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut i parashikon dhe i garanton të drejtat dhe liritë minimale në vijim për të akuzuarit: të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij; t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes; të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, të fitojë mbrojtës sipas detyrës zyrtare; të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët; të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën e përdorur në gjyq.

Një pjesë të këtyre garancive të procesit tashmë i shtjelluam në pjesën e analizës që i referohet të drejtave të të akuzuarve para dhe gjatë fillimit të procedurës. Në këtë pjesë do ta përfshijmë vetëm qasjen në prova dhe intervalin kohor që e ka pasur mbrojtësi për përgatitjen e mbrojtjes.

Arsyeja më e shpeshtë për reagimin nga ana e mbrojtjes është pamundësia për të pasur qasje në provat e mbledhura dhe të propozuara nga prokuroria, por edhe mosdhënia e provave nga organet e tjera shtetërore kur janë kërkuar ato (Grafiku nr.46).




Grafiku nr.46



## ANALIZË e të dhënave nga vëzhgimi i procedurave gjyqësore në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit në vitin 2019

Qasja krahasuese për ta analizuar këtë situatë ndërmjet Gjykatës Themelore Penale - Shkup dhe gjykatave të tjera në vend, e treguar përmes paraqitjes grafike numër 47, tregon se në asnjërën nga gjykatat e tjera mbrojtja nuk ka pasur ndonjë vërejtje sa i përket disponueshmërisë së provave.



Grafiku nr. 47

Sa i përket kohës që do të ishte e mjaftueshme që mbrojtja të jetë në gjendje ta përgatisë strategjinë e saj në mënyrë që ta përfaqësojë siç duhet të akuzuarin, si dhe ekzistimit eventual të ndonjë kufizimi në komunikim, veçanërisht nëse i akuzuari ka qenë në paraburgim dhe të ngjashme, statistikisht tregojnë se reagim është regjistruar vetëm në 2% të lëndëve. E njëjta vlen edhe për kohën që është e nevojshme për përgatitje, përkatësisht avokati i cili ishte emëruar (sipas detyrës zyrtare) në rastin konkret, ishte emëruar një ditë para seancës.

## AKTGJYKIMI


Ligji parashikon shpalljen publike të aktgjykimit, menjëherë sa po të kumtohet ai. Kur gjykata për arsye objektive nuk është në gjendje ta shqiptojë aktgjykimin ditën e njëjtën pas përfundimit të shqyrtimit kryesor, ka mundësi ta shtyjë shpalljen e aktgjykimit më së shumti për tre ditë, me ç'rast do ta caktojë kohën dhe vendin e shpalljes së aktgjykimit. Është paraparë që kumtimet e aktgjyqimeve të lexohen publikisht nga kryetari i këshillit në prani të palëve, përfaqësuesve të tyre ligjorë, të autorizuarve dhe mbrojtësve. Është detyrë e gjykatës që t'i përshkruajë shkurtimisht arsyet për marrjen e një aktgjykimit të tillë, e me këtë rast edhe ta udhëzojë personin e akuzuar për të drejtën e ankimit ndaj aktgjykimit dhe për procedurën e ankimit.

Megjithatë kjo është një nga rekomandimet më të shpeshta në periudhën e kaluar (është regjistruar në pothuajse çdo analizë të lëndëve nga fusha e lëndëve me maturi penale), në rastin konkret, gjegjësisht në këtë fushë konkrete tematike, e kemi bërë përparimin më të madh. Më saktësisht, në vitet e kaluara është regjistruar se gjykata i zbaton gjithnjë e më pak dispozitat e detyrueshme ligjore që kanë të bëjnë me shpalljen e aktgjykimit (Grafiku nr.48). Nëse në vitin 2016<sup>31</sup> Ligji parashikon shpalljen publike të aktgjykimit, menjëherë sa po të kumtohet ai. Kur gjykata për arsye objektive nuk është në gjendje ta shqiptojë aktgjykimin ditën e njëjtën pas përfundimit të shqyrtimit kryesor, ka mundësi ta shtyjë shpalljen e aktgjykimit më së shumti për tre ditë, me ç'rast do ta caktojë kohën dhe vendin e shpalljes së aktgjykimit. Është paraparë që kumtimet e aktgjyqimeve të lexohen publikisht nga kryetari i këshillit në prani të palëve, përfaqësuesve të tyre ligjorë, të autorizuarve dhe mbrojtësve. Është detyrë e

31 Petrovska N., Misoski B., Analiza e të dhënave nga procedurat e vëzhguara gjyqësore në vitin 2016, Koalicioni Të gjithë për gjykim të drejtë, OSBE, Shkup 2016


gjykatës që t'i përshkruajë shkurtimisht arsyet për marrjen e një aktgjykimit të tillë, e me këtë rast edhe ta udhëzojë personin e akuzuar për të drejtën e ankimit ndaj aktgjykimit dhe për procedurën e ankimit.

Megjithëse kjo është një nga rekomandimet më të shpeshta në periudhën e kaluar (është regjistruar në pothuajse çdo analizë të lëndëve nga fusha e lëndëve me maturi penale), në rastin konkret, gjegjësisht në këtë fushë konkrete tematike, e kemi bërë përparimin më të madh. Më saktësisht, në vitet e kaluara është regjistruar se gjykata i zbaton gjithnjë e më pak dispozitat e detyrueshme ligjore që kanë të bëjnë me shpalljen e aktgjykimit (Grafiku nr.48). Nëse në vitin 2016<sup>32</sup>, ndërsa në vitin 2018<sup>33</sup> është përqindja më e ulët e shënuar deri atëherë.




Grafiku nr.48

Këtë vit, në lëndët nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit, vërehet një përqindje e lartë (87%) e aktgjyqimeve të shpallura publikisht (Grafiku nr.49), me atë që, përsëri, Gjykata Themelore Penale - Shkup, gjegjësisht Njësia për Krim të Organizuar dhe Korrupsion në kuadër të saj, është drejtpërdrejt përgjegjëse për këtë përqindje të rritur dhe për heqjen dorë nga praktika e "mbylljes" së gjyqimeve, bile edhe atëherë kur bëhet fjalë për shpalljen e aktgjyqimeve (Grafiku nr.50). Qytetet e tjera në vend kanë një statistikë prej 50% të aktgjyqimeve të shpallura publikisht. Ky informacion është alarmant dhe bën me dije se kjo gjendje duhet të përmirësohet dhe të avancohet sa më shpejt të jetë e mundur, duke e ndjekur shembullin e Gjykatës Themelore Penale - Shkup.



Grafiku nr.49

Aktgjykim i shqiptuar dhe i shpallur publikisht / Paraqitje krahasuese sipas qyteteve




Grafiku nr.50

32 Misoski B., Avramovski D., Petrovska N., Analiza e të dhënave nga procedurat e vëzhguara gjyqësore në vitin 2017, Koalicioni Të gjithë për gjykim të drejtë, Shkup, OSBE, Shkup 2017

33 Misoski B., Avramovski D., Petrovska N., Analiza e të dhënave nga procedurat e vëzhguara gjyqësore në vitin 2018, Koalicioni Të gjithë për gjykim të drejtë, Shkup, Misioni i OSBE-së - Shkup 2018.


## ANALIZË e të dhënave nga vëzhgimi i procedurave gjyqësore në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit në vitin 2019

Kur bëhet fjalë për llojet e aktgjyqimeve që janë shqiptuar gjatë vitit të kaluar, e të cilat kanë qenë subjekt i monitorimit, në aspekt statistikor, të dhënat tregojnë se ka një përqindje të lartë të aktgjyqimeve ndëshkuese, por të pranishme janë edhe aktgjyqimet refuzuese, gjegjësisht liruese (Grafiku nr.51).




Grafiku nr.51  
(Llojet e aktgjyqimeve)

Lidhur me llojin e sanksionit, të dhënat tregojnë se pothuajse  $\frac{3}{4}$  e aktgjyqimeve të shpallura, në vete përmbajnë dënime, ndërsa  $\frac{1}{4}$  dënime alternative (Grafiku nr.52). Fatkeqësisht, duke pasur parasysh faktin se bëhet fjalë për krim të organizuar dhe korrupsion, lëndë në të cilat shumë shpesh fushë tematike është edhe krimi financiar dhe përfitimi i dobisë së paligjshme pronësore nga ana e të akuzuarve, në lëndët që ishin objekt i monitorimit, nuk është regjistruar asnjë rast i shqiptimit të masës së konfiskimit të pronës dhe të dobisë pronësore.



Grafiku nr. 52  
(Llojet e sanksioneve)

Kur bëhet fjalë për këshillat për të drejtat dhe kushtet për ankesë për personin e akuzuar, janë regjistruar vetëm 2 raste (Grafiku nr. 53) në të cilat gjykata nuk e ka këshilluar të akuzuarin për këtë të drejtë të tij. Një supozim i zakonshëm që e bëjnë gjykatësit është se të akuzuarit, posaçërisht në këto lëndë penale, kanë siguruar avokatë të tyre mbrojtës, të cilët do të kenë mundësi që t'ua shpjegojnë këtë atyre, por që, megjithatë, paraqet devijim nga rregulli i përcaktuar në LPP.



Grafiku nr. 52  
(A ia shpjegoi gjykata të akuzuarit kushtet për ankesë)

## PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

- ❑ Është regjistruar një nivel i lartë i shqyrtimeve të shtyra, për shkak të mungesës së disa personave, prania e të cilëve është e detyrueshme. Mungesa e avokatëve mbrojtës dhe e prokurorëve publikë, në përgjithësi, është një nga arsyet kryesore për shtyrjet, por gjithnjë e më shpesh, si shkak është edhe përbërja jo e plotë e këshillit gjyqësor.

### REKOMANDIM:

- ✓ Është e nevojshme që gjykata të bëjë më shumë përpjekje për koordinim gjatë caktimit të shqyrtimeve gjyqësore, e veçanërisht në pjesën që ka të bëjë me menaxhimin e kohës dhe shpërndarjen e gjyqtarëve nëpër këshilla gjyqësorë, që ata të kenë mundësi ta avancojnë punën e tyre në lidhje me këtë çështje.
- ✓ Është e nevojshme që sistemi AKMIS të koordinohet dhe të harmonizohet me oraret e aktiviteteve të të gjitha subjekteve në procedurë.
- ✓ Rritja e numrit të mungesave të gjyqtarëve dhe të prokurorëve mund të jetë një tregues i burimeve të pamjaftueshme njerëzore në gjykatat dhe prokuroritë, prandaj është e nevojshme të bëhen analiza në lidhje me numrin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, por dhe të shërbimeve të tyre profesionale.
- ✓ Kur bëhet fjalë për Njësinë për Krim të Organizuar dhe Korrupsion në kuadër të Gjykatës Themelore Penale - Shkup, vërejmë një trend të përmirësimit sa i përket shtyrjes së shqyrtimeve gjyqësore. Në këtë njësi, në vitin e kaluar, është regjistruar një përqindje më e ulët prej 12% e seancave të shtyra sesa mesatarja e gjykatave të tjera në vend.

- ❑ Zbatimi dominues i masës së paraburgimit kundrejt masave më të lehta për sigurimin e pranisë së të akuzuarit.

### REKOMANDIM:

- ✓ Paraburgimi është akoma masa më e përdorur për sigurimin e pranisë së të akuzuarve, megjithëse ligji e lejon përdorimin edhe të masave më të lehta. Prokuroria duhet të përpiqet t'i zbatojë edhe masat e tjera të parapara me të cilat do të sigurohej prania e të akuzuarve, ndërsa paraburgimi të jetë opsioni i fundit.
- ✓ Vazhdon praktika e gjykatave që të mos japin shpjegime adekuate për arsyet e përcaktimit të paraburgimit, e po ashtu nuk çmohen dhe nuk përmenden as faktorët në vendimet për përcaktimin dhe zgjatjen e masës së paraburgimit nga ana e gjykatave.
- ✓ Ka nevojë për reformë të LPP-së dhe të Ligjit për Shërbimin e Provës, me qëllim të hapjes së mundësisë që shërbimet e provës të kenë kompetenca në aspekt të kontrollit dhe monitorimit të zbatimit efikas të masave më të lehta për sigurimin e pranisë.
- ❑ Është e nevojshme që gjykata t'i kushtojë më shumë vëmendje dhënies së këshillave për të drejtat e të akuzuarve dhe të dëshmitarëve, veçanërisht në gjykatat jashtë Shkupit.

### REKOMANDIM:

- ✓ Zbatimi konsekuent i LPP-së nga ana e gjyqtarëve në lidhje me të drejtat e të akuzuarit gjatë marrjes së tij në pyetje me qëllim të këshillimit të plotë dhe të hollësishtëm për të drejtat e parashikuara në LPP.
- ✓ Është e nevojshme të ndryshohet praktika e interpretimit të dispozitave të LPP-së dhe zbatimi

## **ANALIZË** e të dhënave nga vëzhgimi i procedurave gjyqësore në fushën e krimit të organizuar dhe korrupsionit në vitin 2019

i tyre në praktikë që të mundësohet garanci për drejtësinë dhe objektivitetin e proceseve gjyqësore.

- ❑ Parimi i transparencës së gjykimeve është kryesisht i pranishëm, e kur bëhet fjalë për shqyrtimet që janë të mbyllura për publikun, inkurajues është qëndrimi i Gjykatës Themelore Penale në Shkup për të mundësuar praninë e ekspertëve, që është parashikuar sipas nenit 355 paragrafi 2 të LPP-së. Megjithatë, duke pasur parasysh se një pjesë e gjykatave në vend ende nuk janë plotësisht të hapura për publikun, konsiderojmë se nevojitet përparim në trajtimin e kësaj çështjeje nga ana e gjykatave.

### **REKOMANDIM:**

- ✓ Praktika pozitive e përdorur nga GjThPSH-ja për të mundësuar praninë publikut ekspert në gjykime duhet të zbatohet edhe nga gjykatat e tjera, deri sa të arrihet hapja e tyre e plotë.
- ❑ Është e nevojshme të ndryshohet praktika e nxjerrjes së provave nga ana e gjykatave. Duhet të braktiset sistemi i nxjerrjes së provave duke i lexuar vetëm titujt, edhe atë duke e nxjerrë edhe përmbajtjen e tyre. Gjithashtu duhet të respektohet edhe renditja e nxjerrjes së provave.

### **REKOMANDIM:**

- ✓ Është e nevojshme të bëhet barazimi i praktikës së gjyqtarëve se kur dhe deri në ç'masë mund ta ndryshojnë renditjen e paraparë me ligj të nxjerrjes së provave mbi baza të ndryshme. Gjykatat duhet t'i shpjegojnë në detaje vendimet e tyre për ndryshimin e renditjes së nxjerrjes së provave, me qëllim që të sigurohet se ka barazi të armëve dhe se barra e provës nuk është transferuar mbi mbrojtjen.

- ❑ Prania e praktikës në mesin e gjyqtarëve për të pasur rol aktiv gjatë shqyrtimit kryesor, gjë që i jep publikut përshtypjen se këta janë gjyqtarë të njëanshëm.

### **REKOMANDIM:**

- ✓ Zbatimi konsekuent i dispozitave të LPP-së në aspekt të rolit të gjykatës gjatë shqyrtimit kryesor.
- ❑ Është vërejtur përparim në lidhje me incizimin audio-vizual të shqyrtimeve edhe atë vetëm në Gjykatën Themelore Penale - Shkup, por, megjithatë, mbisundon praktika e mbajtjes së procesverbalit përmes diktimit nga ana e gjyqtarëve.

### **REKOMANDIM:**

- ✓ Është e nevojshme që urgjentisht të braktiset praktika e diktimit, gjegjësisht e parafrazimit të pyetjeve dhe të dëshmimeve nga ana e gjyqtarit. Në këtë drejtim, është e nevojshme të ndahen mjetet dhe burimet e duhura që të mundësohet incizimi audio-vizual i të gjitha shqyrtimeve për ta forcuar objektivitetin, besueshmërinë dhe drejtësinë e procedurës.

- ❑ Vazhdon trendi i shkeljes së të drejtave të procesit të mbrojtjes duke i kufizuar ose duke i zbatuar në mënyrë jo të drejtë dispozitat e LPP-së që kanë të bëjnë me qasjen e avokatëve të mbrojtjes në të gjitha provat me të cilat disponon prokurori publik.

### **REKOMANDIM:**

- ✓ Zbatimi konsekuent i dispozitave të LPP-së, me të cilat parashikohet e drejta për qasje dhe shikim të dokumenteve të prokurorëve nga ana e avokatëve mbrojtës. Si dhe qasja në kohë në të gjitha dokumentet, gjegjësisht provat që lidhen me rastin.

- ❑ Avancimi i parimit të barazisë së armëve në rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

### **REKOMANDIM:**

- ✓ Trajtimi i barabartë i të gjitha palëve në procedurë është thelbësor për përshtypjen e përg-

jithshme për plotësimin e kushteve për gjykim korrekt dhe të drejtë, e përmes prizmit të këtij instituti të barazisë së armëve, kjo është më e dukshme. Prandaj, është e nevojshme që gjykata të kujdeset për trajtimin e barabartë të palëve në procedurë në mënyrë që të mos krijohen përshtypje negative.

- ❑ Ulja e shkallës së transparencës së procedurave, veçanërisht në gjykatat në brendi të vendit, për shkak të disa faktorëve:
  - ◆ Mungesa e pajisjeve elektronike funksionale për publikimin e kohës dhe vendit të seancave të gjykimeve;
  - ◆ Është zvogëluar vëllimi dhe cilësia e të dhënave të publikuara në ueb-faqet e gjykatave që kanë të bëjnë me rastet aktuale, veçanërisht në pjesën e "kalendarit" të gjykimeve, pas integritimit të ueb-faqeve individuale të gjykatave në portalin e integruar të përbashkët: sud.mk.

**REKOMANDIM:**

- ✓ Alokimi i mjeteve të mjaftueshme për mirëmbajtjen teknike të sistemit elektronik për publikimin e kohës dhe vendit të seancave, si dhe avancimi i sistemit elektronik në të cilin publikohen të dhënat për gjykimet.
- ❑ Konfiskimi si masë nuk është aplikuar fare. Është evidentuar mungesa e masës së konfiskimit si në formën e saj themelore, ashtu edhe në formatin e konfiskimit të zgjeruar.

**REKOMANDIM:**

- ✓ Është e nevojshme që prokuroria t'i përdorë dispozitat e ligjit që lejojnë kërkimin dhe shqiptimin e masës së konfiskimit, veçanërisht pasi ky lloj i lëndëve nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit janë kryesisht raste që janë të përshtatshme për ta kërkuar dhe zbatuar këtë masë.
- ❑ Është vërejtur zvogëlimi i transparencës në publikimin e aktgjykimeve, si dhe një tendencë e shtuar për mospublikimin e tyre në qytetet e tjera të vendit, por edhe i mosshpjegimit të kushteve për ankesë për të të akuzuarit. Një përjashtim dhe shembull i mirë në këtë drejtim është Gjykata Themelore Penale në Shkup.

**REKOMANDIM:**

- ✓ Respektimi konsekuent i dispozitave të LPP-së që kanë të bëjnë me shpalljen publike dhe kumtimin e aktgjykimeve, si dhe zbatimi i praktikës pozitive të vendosur nga Gjykata Themelore Penale në Shkup.
- ❑ Edhe këtë vit, sikurse edhe vitin e kaluar, nuk është regjistruar përdorimi i gjuhës diskriminuese dhe, në përgjithësi, diskriminim në bazë të racës ose gjinisë nga ana e gjykatave, gjë që mund të potencohet si praktikë pozitive.
- ❑ Për t'u lavdëruar është edhe praktika e gjyqtarëve që të jenë të përmbajtur dhe të mos nxjerrin përfundim negativ për të akuzuarin, i cili në procedurë është mbrojtur me heshtje.